



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve

“Piano dhe Mësuesi”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc.Dr. Marisa Kërbizi

2. Prof.Asoc.Dr. Dilina Beshiri

Mars 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Arteve
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Interpretimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Arteve “Piano dhe Mësuesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhri Nr.397, datë 10.08.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhri 826, datë 26.12.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 133, datë 19.09.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	II
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	20 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a 2021-2022: 10 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve në "Piano dhe Mësuesi" ofrohet nga Departamenti i Interpretimit, në bashkëpunim me Departamentin KMDP (për modulet A dhe C). Ky program është miratuar për hapje me Urdhër Nr.397, datë 10.08.2011. Programi është në përputhje të plotë me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe synon të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme që i formojnë ata si profesionistë në këtë profil.

Kurrikula e programit është e ristrukturuar në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, në 120 ECTS dhe ofrohet me kohë të plotë në dy vite akademike. Ai realizohet në gjuhën shqipe.

UART ka ndërtuar programin duke respektuar kërkesat e tregut të punës pas studimeve dhe përditësimeve periodike/frekuente që i bën këtij tregu. Programi studimor, ndjek principet e kartës së Bolonjës, dhe kuadrin rregullator të ndërtuar nga Ministria e Arsimit.

Në rregulloren e këtij programi studimi përcaktohen objektivat e programit të studimit: Programi i studimit Master i Arteve "Piano dhe Mësuesi" synon ta pajisë studentin me:

- a) Thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve;
- b) Parapërgatitje për licencën e profesionit të rregulluar;
- c) Aftësim i plotë për zhvillim karriere, brenda dhe jashtë vendit.

Në vitin e studimit 2021-2022, Fakulteti i Muzikës përbëhej nga 50 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë, nga të cilët 46% me tituj shkencorë, 10% e anëtarëve me gradën Doktor, ndërsa 44% janë lektorë dhe asistent lektorë. Programi Master i Arteve në "Piano dhe Mësuesi" mbulohet nga 20 pedagogë të brendshëm dhe 4 të jashtëm.

Fakulteti i Muzikës dhe specifikisht Departamenti i Interpretimit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa partnerë ndërkombëtarë, të tillë si: University of Agder, Norvegji; Conservatorio Superior de Musica de Vigo, Spanjë; Real Conservatorio Superior de Musica "Victoria Eugenia", Spanjë; Conservatorio di Musica "S. Giacomantonio" Cosenza, Itali; Conservatorio di Musica "G. Tartini" Trieste, Itali. Gjithashtu DI ka një memorandum mirëkuptimi me Conservatoire National Superior de Musique et Dance de Paris, si dhe katër marrëveshje për diploma të përbashkëta. Departamenti i Interpretimit, si pjesë e Fakultetit të Muzikës, ka marrëveshje bashkëpunimi me ZVA për zhvillimin e praktikave mësimore. Institucioni bashkëpunon me organizata jofitimprurëse, biznesin, TKOPAB, etj.

Programi i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm për herë të parë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) e nisi punën që në dhjetor të vitit 2022, në komunikim të përbashkët për përcaktimin e detyrave kryesore që do të realizoheshin gjatë procesit të vlerësimit. Në bashkërendim midis dy ekspertëve të jashtëm të vlerësimit dhe stafit të ASCAL u përcaktuan edhe datat e vizitave. Vizitat u realizuan dy ditë konkretisht me datat 30 nëntor dhe 1 dhjetor 2022.

Koordinator teknik me GVJ nga ASCAL në këtë vlerësim ishte Znj. Endra Velaj.

GVJ u njoh me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni në proces akreditimi përmes platformës dhe kredencialet që secili nga vlerësuesit e jashtëm ka në www.ascal.al.

Gjatë dy ditëve të takimeve, Grupi i vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga Prof. Asoc. Dr. Dilina Beshiri dhe Prof. Asoc. Dr. Marisa Kërbizi, zhvilluan takime me Dekanin e Fakultetit të Muzikës, me Përgjegjësën e Departamentit të Interpretimit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin e brendshëm dhe të jashtëm të programit Master i Arteve në "Piano dhe Mësuesi", studentët dhe sekretarinë mësimore, Në ditën e dytë të vizitës, u zhvilluan takime me përfaqësues të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës, Alumni, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Sektorit të Projekteve Artistike dhe Shkencore. Në ditën e dytë u vizituan gjithashtu edhe ambientet e UART, sallat e lektoriumeve, salla e digjitalizuar si dhe biblioteka dhe salla e dëgjimit e pajisur me kompjuterë.

GVJ gjatë takimeve me grupet e caktuara u fokusua në bashkëbisedime konkrete për tema të caktuara si ndërkombëtarizimi, aktivitetet artistike, për planin mësimor, kualifikimin dhe promovimin e stafit, etj.

Gjatë gjithë këtij procesi vlerësimi ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë midis grupit të vlerësimit të jashtëm dhe stafit të UART.



Me datë 27/01/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.52 Prot, Datë 27/01/2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS me datë 10/02/2023 dhe me shkresë zyrtare Nr. 108/4 Prot, Datë 13/02/2023.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:

GVJ në Fusha III - Standarti III.3 kriteri 5, fq. 28

GVJ sugjeron që institucioni të përdorë edhe sisteme antiplagjiaturë.

Komente nga GVB: Për vetë specifikën e programit të studimit Master në Piano dhe Mësuesi, i cili në lëndët me interpretim muzikor në kohë reale i realizon provimet me lojë live, para komisionit të provimit apo diplomës, me prezencë publiku (pra, jo me dyer të mbyllura) pamundësohet objektivisht dukuria e kopjes apo e plagjiaturës në provime dhe detyra. Në lidhje me punimin teorik të tezës së diplomës, duhet nënvizuar fakti që ai është një material analize i formës muzikore, specifikave të kompozitorit, idesë kompozicionale dhe elementëve stilistikorë e estetikë, mbi veprën e përzgjedhur për t'u interpretuar live gjatë provimit të diplomës, i cili zbërthen dhe ndërton logjikën dhe etapat interpretative në tërë kohëzgjatjen e saj. Pavarësisht këtij fakti, duke vlerësuar gjetjen e GVJ, Grupi i punës që ka punuar për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm Programit të Studimit Master në Piano dhe Mësuesi, do të sugjerojë përmes DI dhe Dekanatit të FM që Universiteti i Arteve të mundësojë një platformë antiplagjiaturë për verifikimin e punimeve teorike apo diplomave për t'u përdorur sipas nevojave që mund të dalin nga Departamentet e ndryshme të vetë Universitetit apo organet e tij drejtuese.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, GVJ vlerëson angazhimin e insitucionit për mundësimin e platformës antiplagjiaturë.

GVJ i qëndron vlerësimit të mëparshëm.

GVJ në Fusha III - Standarti III.5, kriteri 6, fq. 31-32

Në evidencë paraqitet modeli i vlerësimit të diplomës duke u bazuar në Rregulloren Mësimore të Ciklit të dytë Master. GVJ sugjeron që modeli i paraqitur, duhej t'i përkiste programit Master i Arteve "Piano dhe Mësuesi".

Komente nga GVB: Modeli i diplomës së programit të studimit Master i Arteve në Piano dhe Mësuesi është i ngarkuar në evidencat shtesë të dërguara në ASCAL më datë 21.10.2022. Suplementi i Diplomës gjendet tek Evidenca III.5.7.1

Komente nga GVJ: Evidenca III.5.7.1 "Model Diplome", edhe pse rezultoi e listuar në dokumentin nr.7 që bën inventarizimin e të gjithë evidencave që janë përdorur në raport, nuk gjendet si dokument specifik brenda folderit (për shkak të një kalimi nga evidenca III.5.3.1 në evidencën III.5.7). Por duke qenë se UART rezultoi nga vizita në terren që punonte duke respektuar Udhëzimin e MASR, Nr.11, datë 02.04.2020 "Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së suplementit të diplomës", ky standard u vlerësua plotësisht i përmbushur.

GVJ i qëndron vlerësimit të mëparshëm.

❖ STANDARDI IV.3

Kriteri 4:

GVJ ndër të tjera komenton: Rekomandohet shtimi i fondit të teksteve fizike dhe elektronike në fushën e edukimit (literature bazë dhe e këshillueshme).

Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DI argumenton: Në vijim të rekomandimit të GVJ pohojmë se në Bibliotekën e Universitetit të Arteve janë shtuar fizikisht dhe online librat me tituj si më poshtë vijon:
DIMENSIONET E MENDJES - Teoria e llojeve të ndryshme të inteligjencës, Howard Gardner
FORCAT E NDRYSHIMIT NË ARSIM, Eksplorimi I thellësive të reformës arsimore, Michale Fullaun
KULTURA, MENDJA DHE EDUKIMI, Jerome Bruner
KURRIKULA, BAZA, PARIME DHE PROBLEME, Allan C. Ornstein, Francis P. Hunkins
MENDJA E PASHKOLLUAR, Havard Gardner
MANUAL I PEDAGOGJISË SË PËRGJITHSHME Franco Fraboni & Franca Pinto Minerva
PSIKOLOGJIA E ZBATUAR NË MËSIMDHËNIE – Ylli Pango
PËRQASJE TË KURRIKULËS NË BAZË SHKOLLE Prof. as. Marita Hamza, Yllka Spahiu
Gjithashtu, Biblioteka ka vënë në dispozicion të gjitha botimet online të hartuara nga ASCAP (Agiencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar) përmes website të këtij institucioni (ascap.edu.al), duke orientuar studentët për botimet si: udhëzues.

Përgjigjja GVJ: GVJ vlerëson përkushtimin e institucionit për shtimin e fondit të librave me karakter psiko-pedagogjik dhe ***i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.***

❖ STANDARDI V.4

Kriteri 5:

GVJ ndër të tjera komenton: Institucioni nuk ka paraqitur një raport analitik periodik mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre.

Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DI argumenton: Në raportin vjetor që hartohet nga DI merret në shqyrtim dhe krahasohet profili dhe cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve Pianistë, krahas studentëve të programeve të tjerë të studimit. Duke vlerësuar gjetjen e GVJ, Departamenti i Interpretimit, kërkon ndjesë që për arsye teknike nuk ka bashkalidhur me të dhënat tabelore të tjera, evidencën për cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. Lutem konsiderojeni si tabelë, pasi janë të dhëna të cilat janë dërguar nga Sekretaria Mësimore e Fakultetit për çdo program në proces akreditimi. Sidoqoftë, specifika e vetë programit të studimit, konkurrueshmëria profesionale dhe niveli i lartë i punësimeve të studentëve pianistë në periudhën e marrë në shqyrtim (2019-2022), dëshmojnë efektivisht për një përmbushje të elementëve cilësorë e sasiorë të përgatitjes së studentëve pianistë përgjatë studimeve Master në Piano dhe Mësuesi.

- Të punësuar – 12 Pianistë nga 14 të Diplomuar do të thotë që 85% e të diplomuarve janë punësuar në Arsimin Parauniversitar dhe Universitar si më poshtë:

Në Fakultetin e Muzikës të UART – 1 (specialiteti Piano) – Laura Lila



Në Shkollën e Muzikës Lezhë - 3 (specialiteti Piano) – Sara Luka, Synjona Papeleka, Enis Ismaili.

Në Shkollën Ajet Xhindole Berat - 1 (specialiteti Piano) – Jurgen Kokiçi

Në Shkollën Artistike “Jan Kukuzeli” Durrës – 2 (specialiteti Piano) –Fitnete Xhakozi, Nancy Kume.

Përgjigjja GVJ: GVJ pasi shqyrtoi dokumentet e ridërguara nga institucioni merr në konsideratë dokumentacionin e dërguar dhe ndryshon vlerësimin e tij për standardin V.4 nga **përmbushet kryesisht në përmbushet plotësisht.**

❖ STANDARDI V.5

Kriteri 2:

GVJ ndër të tjera komenton: Institucioni nuk ka paraqitur asnjë evidencë që të dëshmojë ngritjen dhe funksionimin e Këshillave Studentore.

Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DI argumenton: Këshilli studentor i Universitetit të Arteve, për numrin relativ jo të lartë të studentëve të tij, është i përbërë nga përfaqësues nga të tre fakultet e tij në mënyrë të barabartë. Kwshilli funksionon normalisht dhe është tepër aktiv si në faqen web të UART dhe na rrjetet sociale. Kryetar i Këshillit studentor është zgjedhur Erlind Fusha nga Fakulteti i Arteve të Bukura. Është i pasqyruar në faqen online të Universitetit të Arteve.

<http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=136&niveli=79>

Përgjigjja GVJ: GVJ vlerëson përkushtimin e institucionit për të publikuar në faqen zyrtare të UART, njoftimin për Kryetar të Këshillit studentor, por institucioni nuk ka paraqitur asnjë evidencë që të dëshmojë ngritjen, funksionimin, rregulloren e Këshillave Studentore. Si rrjedhojë, **GVJ i qëndron vlerësimit fillestar.**

❖ STANDARDI VI.1

Kriteri 2:

GVJ ndër të tjera komenton: Rezulton se, institucioni nuk ka paraqitur evidenca që të dëshmojnë vlerësimin në mënyrë periodike te punës artistike- mësimore dhe shkencore të stafit akademik të FM.

Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DI argumenton: Në lidhje me këtë pikë, GVB me përgjegjësi shprehet se: Vlerësimi në mënyrë periodike i punës artistike-mësimore shkencore i stafit akademik të Fakultetit të Muzikës është pasqyruar në Analizën Vjetore të këtij Fakulteti. Kjo evidencë gjendet tek Dosja e Vetvlerësimit si Evidenca Nr I.I.3.1.15 e ngarkuar në sistemin AMS më datë 16.10.2022. E njejt Evidencë është ngarkuar sërish me Evidencë Nr VI.2.4.3, e ngarkuar në Sistemin AMS më datë 22.12.2022

Përgjigjja GVJ: GVJ vlerëson përkushtimin e institucionit, por **GVJ i qëndron vlerësimit fillestar.**

❖ STANDARDI VI.2

Kriteri 1:

GVJ ndër të tjera komenton: Nga vizita në institucion dhe bazuar në organigramën e UART, rezulton se intitucioni ka në strukturë të saj njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, por është ende në proces realizimi. Rekomandohet ngritja e NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë referuar, Nenit 35 të Statutit UART.

Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DI argumenton: Komisioni Ad Hoc për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, i ngritur nga Rektori i UART me Urdhër Nr. 15/1, datë 20.09.2022 "Për krijimin e Komisionit Ad Hoc për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë", shpreh falenderimet e të gjithë anëtarëve të Komisionit, për korrektesën e Ekspertëve të Vlerësimit gjatë ditëve të vizitës në UART. Duke shpresuar që ajo çka ne i paraqitëm këtij Grupi vlerësimi edhe gjatë takimit që patëm në UART, do konsiderohet nga ekspertët, rithemi se Komisioni Ad Hoc në përbërje të cilit janë 8 anëtarë: dy Zv. Rektorët, tre Përgjegjësit e Departamenteve përfaqësues të çdo Fakulteti si edhe Sektori Mësimor dhe i Kurrikulës, ka mbuluar më së miri sigurimin e cilësisë në UART, Komision i cili edhe pas përfundimit të këtij procesi, po punon për ngritjen dhe mirëfunksionimin e kësaj strukture në zbatim të Statutit të UART. Ju bëjmë me dije se është ngritur Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, përbërja e të cilit është sipas përcaktimeve të nenit 35 të tij sipas Statutit të UART.

Përgjigjja GVJ: GVJ vlerëson përkushtimin e institucionit për krijimin e Komisionit Ad Hoc për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, por rekomandohet ngritja e NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë referuar, Nenit 35 të Statutit UART.

GVJ i qëndron vlerësimit fillestar.

❖ STANDARDI VI.2

Kriteri 4:


GVJ ndër të tjera komenton: Rekomandohet ngritja e instrumenteve matës për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive të punës artistike-mësimore dhe shkencore të stafit akademik si dhe hartimi i raporteve periodike për ecurine e tyre.

Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DI argumenton: Në lidhje me këtë pikë, GVB me përgjegjësi shprehet se: Vlerësimi në mënyrë periodike i punës artistike- mësimore shkencore i stafit akademik të Fakultetit të Muzikës është pasqyruar në Analizën Vjetore të këtij Fakulteti. Kjo evidencë gjendet tek Dosja e Vetvlerësimit si Evidenca Nr I.I.3.1.15 e ngarkuar në sistemin AMS më datë 16.10.2022. E njëjta Evidencë është ngarkuar sërisht me Evidencë Nr VI.2.4.3, e ngarkuar në Sistemin AMS më datë 22.12.2022 Gjithësesi, instrumentat matës për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive të punës artistike-mësimore dhe shkencore të stafit akademik si dhe hartimi i raporteve periodike për ecurine e tyre, për vetë specifikën e profesionit të personelit akademik interpretues ku hyjnë edhe pianistët, kanë të ngërthyer elementët vlerësues si në mundësitë që studentët kanë për të përzgjedhur profesorin/ profesoreshën e tyre, si dhe pjesëmarrjen tepër aktive të personelit akademik në jetën koncertale si në institucion ashtu edhe në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare. Për më tepër, në kualifikimin e personelit akademik të programit të studimit Master në Arte, Piano dhe Mësuesi, mund të dëshmojnë titujt akademikë apo shkencorë të fituar (Profesor Doktor, Profesor, Profesor i Asociuar Doktor, Profesor i Asociuar, Doktor), të cilët flasin për një përqendrim të elementëve më të spikatur të

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se: Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, ofron programin e studimit Master i Arteve në "Piano dhe Mësuesi", program i cili fuqizon dhe konsolidon vlerat kulturore e akademike kombëtare, përmes përgatitjes së thelluar të artistëve dhe mësimeve në fushën e muzikës. Programi Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi”, është hartuar në përputhje me qëllimin dhe misionin e UART. Referuar nenit 4 të Statutit të UART, ky është një program i ngritur me qëllim: a) Për të krijuar, zhvilluar, përçarur dhe mbrojtur dijet përmes mësimeve, në fushën e artit dhe të kulturës, si dhe të nxisë dhe zhvillojë kërkimin artistik/shkencor. b) Pë të formuar specialist të lartë në fushat e arteve dhe për të krijuar artistët e rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit. Gjithashtu, ky program përkon me misionin e UART, për:
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<ul style="list-style-type: none">- ofrimin e arsimit të lartë profesional dhe veprimtarisë krijuese në fushën e artit dhe kulturës;- zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimeve dhe veprimtarisë artistike që kryhet brenda dhe jashtë vendit;- formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës;
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Institucionit.	<ul style="list-style-type: none">- thellimin e kualifikimit profesional artistik dhe shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e kulturës;- ndihmesën në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit dhe cilësisë së shoqërisë, si dhe përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë; Gjithashtu, programi Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” është hartuar duke zbatuar Strategjinë e UART për zhvillim, pika 2 dhe pika 2.1, ku saktësohet qëllimi për “forcimin e mësimeve”, si edhe “ritjen e numrit të projekteve artistike” e “ritjen e kontributit në jetën kulturore e artistike të vendit”.



	<p>Ky program është hartuar duke respektuar tërësisht kuadrin ligjor në fuqi. Ky program synon promovimin e kulturës dhe vlerave kombëtare në fushën e muzikës së interpretuar dhe përhapjen e këtyre vlerave brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Dokumenti: I.I.1.1.1 Ligji 80/2015-2015-07-22-80 Per arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor</i> <i>Dokumenti: I.I.1.3.3 VSA Mbi miratimin e Planit të zhvillimit strategjik të UART, për vitet akademike 2018-2025</i> <i>Dokumenti: I.I.1.3.7 Rregullore e Universitetit të Arteve, VSA, Nr.20, dt.07.10.2021</i> <i>Dokumenti I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF</i> <i>Dokumenti: I.I.1.3.8 Rregullore mësirnore e programit të studimeve të Ciklit të Dytë Master</i> <i>Dokumenti: Rregullore studimi "Piano dhe Mësuesi:</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve "Piano dhe Mësuesi" është hartuar duke marrë në konsideratë strategjitë zhvillimore jo vetëm të institucionit, por edhe strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet ndërkombëtare parashikuar nga UNESCO. Ky program është hartuar duke respektuar kërkesat e tregut të punës pas studimeve dhe përditësimeve periodike që i bëhen këtij tregu. Programi është hartuar në përputhje me kuadrin rregullator të ndërtuar nga Ministria e Arsimit, duke përshtatur në kontekstin shqiptar përvojat më të mira evropiane.</p> <p><i>Dokumenti: I.I.1.4.1 Strategjia Kombëtare për zhvillim dhe Integrim 2015-2020</i> <i>Dokumenti: I.I.1.4.2 Draft-Strategjia për Arsimin 2021-2026-1</i> <i>Dokumenti I.I.1.1.2 Ligj 10247, datë 4.03.2010, Për Kornizën shqiptare të Kualifikimeve, ndryshuar.</i> <i>Dokumenti: Korniza Evropiane të Kualifikimeve</i> <i>Dokumenti: Guida e UNESCO per arsimin: Unpacking Sustainable Development Goal 4 Education 2030</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve "Piano dhe Mësuesi" është një program i cili fuqizon dhe konsolidon vlerat kulturore e akademike kombëtare, përmes përgatitjes së thelluar të artistëve dhe mësimeve në fushën e muzikës. Programi synon promovimin e kulturës dhe vlerave kombëtare në fushën e muzikës së interpretuar dhe përhapjen e këtyre vlerave brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Ky standard përmbushet plotësisht.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë



përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi”, ofrohet nga Departamenti i Interpretimit - DI, në bashkëpunim me Departamentin KMDP (për modulet A dhe C). Këto departamente përbëhen nga një staf me përvojë të gjatë artistike e akademike, me tituj dhe grada.</p> <p>Në vitin e studimit 2021-2022, Departamenti i Interpretimit përbëhej nga 50 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë dhe 38 me kohë të pjesshme. Pra, rreth 57% e stafit mësimdhënës përbëhet nga lektorë me kohë të plotë.</p> <p>Stafi akademik me kohë të plotë, përbëhet nga 42% profesorë me tituj (Profesor dhe Profesor i Asociuar), të promovuar përmes veprimtarive artistike dhe 4% profesorë me tituj shkencorë (Prof. Dr. dhe Prof. As. Dr.). 10% e anëtarëve me kohë të plotë të Departamentin kanë gradën Doktor, ndërsa 44% janë lektorë dhe asistent lektor.</p> <p>Nga shikimi i CV të personelit akademik, si me kohë të plotë, rezultoi se në kategori të tilla si lektorë apo Asistent lektorë, janë figura të rëndësishme të fushës së muzikës. Kjo do të thotë se stafi akademik, është tërësisht i kualifikuar me lektorë me përvojë të pasur artistike, të cilëve i mungon promovimi përmes titujve.</p> <p>Si përfundim, DI ka të gjithë kapacitetet e duhura në fushën akademike e specifike për ofrimin e këtij programi.</p> <p>GVJ sugjeron rinisjen e procedurës për promovimin e stafit dhe fitimit të titujve, përmes vlerësimit të kontributit të tyre artistik, duke respektuar statusin e veçantë që ka institucioni.</p> <p><i>Dokumenti: 1.1.1.1.16 Jetëshkrimet e PE të DI</i> <i>Dokumenti: 112.1.3 Tabelat e personelit akademik</i> <i>Dokumenti: Planifikimi i personelit të FM nga DI</i> <i>Dokumenti: 1.1.2.1.3 Tabelat Personeli.pdf</i> <i>Dokumenti: 06 Sylabus në Piano dhe Mësuesi</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” përputhet me fushën akademike të njësisë kryesore, Fakultetit të Muzikës dhe të njësisë bazë, Departamenti të Interpretimit. Departamenti ofron edhe programe të tjera studimi si në nivel e parë dhe të dytë. Lloji i programit të studimit dhe diploma që lëshohet me mbarimin e tij, emërtimi i programit të studimit, orientimi, gjuha e studimeve, forma e studimeve, kohëzgjatja e studimeve, aktorët e interesit, studimi i tregut përpara hapjes së programit dhe vlerësimi dhe shpërndarja e krediteve janë në përputhje me standardet e vendosura kombëtare dhe evropiane.</p> <p>Fakulteti i Muzikës në zbatim të normave të klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit vepron sipas direktivave dhe udhëzimeve</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme</p>	<p>Fakulteti i Muzikës në zbatim të normave të klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit vepron sipas direktivave dhe udhëzimeve</p>



<p>dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>kombëtare e europiane duke klasifikuar dhe koduar programet e studimit.</p> <p><i>Dokumenti: I.1.2.2.1 "International Standard Classification of Education: Fields of Education and Training 2013" UNESCO</i></p> <p><i>Dokumenti: I.1.2.2.2 VKM 41 date 24/01/2018 "Per elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë"</i></p> <p><i>Dokumenti: Syllabus në "Piano dhe Mësuesi"</i></p>		
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p>	<p>Nuk aplikohet.</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Institucioni nuk aplikon trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar, por i angazhon këta të fundit në aktivitete artistike (produksioni të ofruara nga institucione publike dhe OJF), të cilat ofrojnë trajnime "Learning by doing". Këto aktivitete kontribuojnë në fuqizimin artistik të Alumni, promovimin e tyre dhe prezantimin e suksesshëm të tyre tek punëmarrësit potencialë (TKOPAB etj).</p> <p><i>Dokumenti: Buletini i aktiviteteve të organizuar për 60-vjetorin e UART.</i></p> <p><i>Dokumenti: I.1.1.5.2 Foto Nr. 7 Workshop</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master i Arteve në "Piano dhe Mësuesi", ofrohet nga Departamenti i Interpretimit - DI, në bashkëpunim me Departamentin KMDP (për modulet A dhe C). Këto departamente përbëhen nga një staf me përvojë të gjatë artistike e akademike, me tituj dhe grada. Ky program i ciklit të dytë janë vazhdim i programit Bachelor në "Piano". Ky program është ndërtuar në zbatim të normave të klasifikimit / kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Njësia bazë e këtij programi studimi, Departamenti i Interpretimit bashkëpunon me njësitë e tjera brenda institucionit si ato akademike, ashtu edhe ato administrative për të siguruar mbarëvajtjen e realizmit me sukses të programit të studimit. Departamenti bën ndarjen e detyrave dhe koordinimin mes personelit akademik të departamentit duke përcaktuar përgjegjësitë si në nivel akademik, ashtu edhe nga pikëpamja administrative.</p> <p>UART ka një bazë rregullatore të detajuar dhe akte që përcaktojnë rolin dhe detyrat funksionale si të departamenteve, dekanatit, etj.</p> <p>Departamenti në mënyrë periodike bën analizimin e ecurisë së procesit mësimdhënës dhe realizmin e bashkëpunimit në funksion të procesit mësimor.</p> <p>Në bazë të përcaktimeve të Statutit të UART dhe Rregulloreve përkatëse, në përfundim të çdo viti akademik realizohen analizat vjetore të punës mes njësive dhe personelit.</p> <p><i>Dokumenti: I.I.3.1.14 Urdhër i Rektorit për zhvillimin e analizës vjetore</i> <i>Dokumenti: I.I.3.1.15 Analize vjetore nga DI dhe Fakulteti i Muzikës</i> <i>Dokumenti: Rregullore e programit "Piano dhe Mësuesi"</i> <i>Dokumenti: Rregullore UART</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UART ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me organizma biznesi vendas ose të huaj. Departamenti i Interpretimit, ku ofrohet programi Master i Arteve në "Piano dhe Mësuesi" ka marrëveshjet e mëposhtme të bashkëpunimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - University of Agder — Norvegji - Conservatorio Superior de Musica de Vigo — Spanjë - Real Conservatorio Superior de Musica "Victoria Eugenia" — Spanjë - Conservatorio di Musica "S. Giacomantonio" Cosenza — Itali - Conservatorio di Musica "G. Tartini" Trieste — Itali <p>Gjithashtu, DI ka një memorandum mirëkuptimi me Conservatoire National Superior de Musique et Dance de Paris, si dhe katër marrëveshje për diploma të përbashkëta.</p> <p>DI ka marrëdhënie të shkëlqyera me biznesin vendas dhe të huaj, përmes së cilave është bërë e mundur restaurimi i sallës së madhe të koncerteve.</p> <p><i>Dokumenti: I.I.3.2.8 . ROMA TOR VERGATA.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.3.2.6 . vigo double degree.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.3.2.3 2022 GRANADA .interinstitutional-agreement_conservatorio musica granada_2022.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.3.2.9 TAP FINANCON RIKONSTRUKSIONIN E</i></p>



	<i>Universiteti T E Arteve.pdf</i>			
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	<p>Universiteti i Arteve dhe Fakulteti i Muzikës ka nënshkruar marrëveshje për realizimin e praktikave profesionale, praktikave të punës apo stazhit me institucione dhe njëkohësisht bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikqyrjen e praktikës. Marrëveshjet për studentët e programit të studimit Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” janë me Drejtoritë e ZVA Tiranë, Vlorë, Korçë, Elbasan, Berat dhe Kurbin. Gjithashtu, studentët përfshihen në angazhime të përkohshme në sezone koncertale të Orkestres së Teatrit Korabëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit, apo dhe të organizatave jofitimprurëse.</p> <p>Në funksion të mobilitetit të studentëve lidhur me realizimin e praktikave profesionale artistike, DI ka përfituar nga bursa Erasmus, për realizimin e internship-it pranë institucioneve artistike të Spanjës.</p> <p>Sipas analizave periodike të bëra për programin “Piano dhe Mësuesi”, rezulton se që nga viti 2018-2019 janë aprovuar 2 mobilitete për studentë (Norvegji) dhe janë realizuar 2 të tjera (Norvegji).</p>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p><i>Dokumenti: I.1.3.3.2 Marreveshje FM me ZVA Vlore.pdf</i> <i>Dokumenti: I.1.3.3.3 KLevis Delibashi Internship LA.pdf</i> <i>Dokumenti: I.1.3.4.1 Universiteti i Arteve - Statistikat ICM - shtator 2022.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Departamenti ka një bashkëpunim shumë të mirë me njësitë e tjera brenda institucionit, si ato akademike ashtu edhe ato administrative për të siguruar mbarëvajtjen e realizimit me sukses të programit të studimit. Bashkëpunim i mirë evidentohet gjithashtu me institucione partnere ndërkombëtare, me biznesin dhe organizatat jofitimprurëse, ZVA, etj.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADIINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënljgore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Sipas Legjislacionit në fuqi dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit, programi Master i Arteve “Piano dhe Mësuesi” është organizuar në lëndë dhe module. Ky organizim respekton sistemin European të transferimit dhe grumbullimit të krediteve.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” strukturohet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Moduli - LËNDË BAZË - përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (24 ECTS) - Moduli - LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinen shkencore - artistike (53 ECTS) - Moduli - LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE - nëndisiplina, profile dhe grup lëndë me zgjedhje (9 ECTS) - Moduli - LËNDË ME ZGJEDHJE (4 ECTS) - Moduli - LËNDË PLOTËSUESE - praktika profesionale (8 ETC) - Moduli - DETYRIME PËRMBYLLËSE (22 ETC) <p>Syllabuset përfshijnë të gjithë informacionin e nevojshëm, si kodi, emërtesa e lëndës, semestri, cikli, programi mësimor etj, por formatimi i programit lëndor duhet bërë sipas formatit specifik të parashikuar.</p> <p><i>Dokument: II.1.3.1 VKM-nr.-879-dt-18.12.2019-Për-disa-ndryshime-në-VKM-nr.-41-dt-24.1.2018-Për-elementët-e-programeve-të-studimit...-1.pdf</i></p> <p><i>Dokument: II.1.1.8 SYLABUS PIANO DHE MËSUESI.pdf</i></p> <p><i>Dokument: I.I. 1.1.7 Plani mësimor i programit të studimit Master në Arte “Piano dhe Mësuesi”</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të</p>	<p>Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i artistëve dhe mësimdhënësve në fushën e muzikës.</p> <p>Gjatë vizitës dhe diskutimit me studentët në UART, GVJ u njoh edhe me mundësitë që lëndët japin si njohuri paraktike, ashtu edhe teorike për realizimin e këtij qëllimi. Arritja e plotë e qëllimeve të programit paraqitet edhe nëpërmjet numrit të lartë të punësimit të studentëve dhe ALUMNI, sipas të dhënave të matura nga Institucioni dhe nga intervista me studentët.</p>

<p>paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” është hartuar në përputhje me VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruar në IAL”. Ky program e realizon qëllimin e tij përmes dy praktikave: Praktika e mësimitdhënies - 3 ECTS dhe Praktika artistike 1 ECTS. Praktika e mësimitdhënies zhvillohet në institucione arsimore, sipas marrëveshjeve paraprake që institucioni ka me ZVA, ndërsa praktika artistike realizohet përmes koncerteve.</p> <p><i>Dokumenti: I.I.2.2.2 VKM.1 Vendimi-I-KM-Nr.-41-datë-24012018.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.3.3.2 Marreveshje FM me ZVA Vlore.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.1.1.5 Urdher-Nr.100-dt.25.2.2022-RREGULLORJA-PER-ZHVILLIMIN-E-PRAKTIKAVE-PROFESIONAL-TE-MESUESIT.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Programi Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” është vazhdim i programit Bachelor në Piano. Në ciklin e parë studenti fuqizohet me njohuritë bazë, dhe vazhdon në Master për të thelluar formimin e tij në fushën artistike dhe të mësimitdhënies, duke i aftësuar studentët Pianistë me kapacitete e shprehi të punës në mësimitdhënie, në sektorin e arsimit të mesëm të ulët ose të lartë.</p> <p><i>Dokumenti: 03 plan mesimor.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.1.1.14 bachelor-piano-21-22.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Programi Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” është i organizuar në 120 ECTS dhe përmban 25% ECTS në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik, të ndara si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 24 kredite - Lëndët Bazë (Moduli A) - 6 kredite - Lëndë plotësuese (Moduli D). <p>UART është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë që ofron një program të tillë, ndaj ngjashmëria 80% e kurrikulës me programe të tjera është e paaplikueshme.</p> <p><i>Dokumenti: 03 plan mesimor.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.2.2.2 VKM.1 Vendimi-I-KM-Nr.-41-datë-24012018.pdf</i> <i>Dokumenti: VKM Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënie e Statusit të veçantë UART si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimit i</p>	<p>Programi Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi”, organizohet dhe funksionon në përputhje me bazën ligjore në fuqi: Ligjin 80/2015, “Për</p>



<p>studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor”, VKM 41, datë 24.01.2018, VKM Nr. 145, date 10.03.2021, etj. Pranimi i studentëve realizohet me konkurs, referuar Statutit të UART, neni 92. Programi i studimit Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” financohet sipas përcaktimit të DI, për shkak se UART është institucion i arsimit të lartë me status të veçantë. Megjithatë financimi i tij bëhet sipas Statutit të UART, por edhe VKM 780 date 26.12.2018.</p> <p><i>Dokumenti: I.1.1.1.1 Ligj Per Arsimin e Larte.pdf</i> <i>Dokumenti: I.1.2.2.2 VKM.1 Vendimi-I-KM-Nr.-41-datë-24012018.pdf</i> <i>Dokumenti: II.1.6.5 VKM-780-Ulje-tarifa-Cikli-i-Dyte-min.pdf</i> <i>Dokumenti: I.1.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF</i></p>		
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Nuk aplikohet.</p>		
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” ka kodin përkatës, duke i’u referuar klasifikimeve të MAS në VKM Nr.330, datë 11.05.2022 dhe Standarteve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit (Fields of Education and Trainings 2013).</p> <p><i>Dokumenti: II.1.8.1 vendim-2022-05-11-310.pdf</i> <i>Dokumenti: I.1.1.1.8 isced-fields-of-education-and-training-2013-en.pdf</i></p>		
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Nuk aplikohet.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Konstatohet se programi i studimit ka përcaktuar ngarkesën e krediteve sipas Sistemit European për Transferimin dhe grumbullimin e kredive dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar dhe që nga viti 2019 i përmbahet sistemit të kodimit ISCED, referuar VKM Nr.330, datë 11.05.2022.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore e njësia bazë përgjegjëse për programin ka përmbushur detyrimet ligjore për organizimin, vlerësimin dhe akreditimin. DI ka një staf prej 50 anëtarësh, nga të cilët 28 janë me tituj akademikë dhe grada, performanca akademike e së cilëve vlerësohet periodikisht nga përgjegjësi i Departamentit dhe studentët.</p> <p>Vlerësimi i brendshëm realizohet nga GVB, i ngritur me Vendim Dekanati, Nr. 86 Prot, datë 07.03.2022, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015, dt. 22.07.2015 "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë", neni 104, në mbështetje të Statutit të UART.</p> <p><i>Dokumenti: II.5.1.7 komunikim zyrtar shkresor per akreditimin.pdf</i> <i>Dokumenti: II.5.1.1 urdhëri 616 për ngritjen e grupit të punës.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.1.1.1 Ligj Per Arsimin e Larte.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Praktika mësimore realizohet në Departament nga strukturat përkatëse. Angazhimi i personelit akademik për realizimin e praktikave mësimore bëhet në bashkëpunim me ZVA-të, në drejtimin e pedagogut që kryen rolin e mentorit mbikqyrës, në përputhje me rregulloren e zhvillimit të praktikave profesionale.</p> <p>Praktika profesionale dhe detyrimet përmbyllëse lidhen me dy nga modulet e planit mësimor:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Praktika e Mësimdhënies - 3 ECTS - Praktika Artistike - 1 ECTS. <p>Departamenti i Interpretimit ku ofrohet program, e realizon praktikën e mësimdhënies së studentëve duke u bazuar në marrëveshje bashkëpunimi midis Fakultetit të Muzikës me Zyrat vendore arsimore. Praktika artistike, 1ECTS, organizohet në formën e koncerteve dhe aktivitete tjera artistike.</p> <p>Të dhënat për praktikën e studentit figurojnë në skedën për praktikën dhe formularin e vlerësimit.</p> <p>Në takimin me studentët u vu re se studentët realizojnë praktikën mësimore në shkollat e qyteteve nga vijnë.</p> <p>Kjo praktikë e mirë, ndihmon në promovimin e edukimit dhe mësimin të instrumentit në atë shkollë.</p> <p><i>Dokumenti: I.I.3.3.2 Marreveshje FM me ZVA Vlore.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.3.3.1 Tabela 5 Marreveshjet.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.1.1.5 Urdher-Nr.100-dt.25.2.2022-RREGULLORJA-PER-ZHVILLIMIN-E-PRAKTIKAVE-PROFESIONAL-TE-</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	

	<i>MESUESIT.pdf</i>			
Konkluzione	<p><i>Nga ana e GVJ u konstatua se detyrimet dhe veprimtaritë e këtij programi përmbushen në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015, Neni 24 / Pika 4 dhe Rregullores së Fakultetit të Muzikës.</i></p> <p><i>Përqindja e parashikuar bazuar në udhëzimet e MASR mes stafit me kohë të plotë të anagazhuar dhe stafit me kohë të pjesshme të angazhuar është 70% PAE me 30 % PAK. Praktika mësimore dhe artistike realizohen në përputhje me Rregulloren për zhvillimin e praktikave profesionale.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Të gjitha të dhënat për përmbajtjen e programit, si dhe informacione lidhur me strukturën dhe organizimin e tij, gjenden në Rregulloren mësimore të ciklit të dytë Master, si dhe në Rregulloren e programit të studimit Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi”.</p> <p><i>Dokumenti: Rregullore dhe kriteret per studimet master viti 2022-2023</i> <i>Dokumenti: Rregullore e DI</i> <i>Dokumenti: 06 Rregullore studimi piano.pdf</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	<p>Plani mësimor i programit të studimit Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” përmban të gjithë informacionet e nevojshme për grupimin e lëndëve në module, në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve, orët në auditore, format e mësimdhënies, format e kontrollit si dhe kreditet sipas ECTS, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p><i>Dokumenti: 03 plan mesimor.pdf</i></p>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Programi Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” ka të gjitha informacionet e nevojshme për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Të gjitha këto janë të paraqitura në Rregulloren e UART, Statutin e UART, Rregulloren e ciklit të dytë të studimit, Rregulloren e programit të studimit Master i Arteve “Piano dhe Mësuesi”. Bazuar në ligjin 80/2015 (me Nenet 75, 76, 89) realizohet pranimi, transferimi dhe ekuivalentimi i studimeve.</p> <p><i>Dokumenti: I.I.I.1.1 Ligj Per Arsimin e Larte.pdf</i> <i>Dokumenti:</i></p>



	<p>Dokumenti: <i>I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF</i></p> <p>Dokumenti: <i>I.I.1.3.7 Rregullore e Universitetit te Arteve VSA_Nr.20_dt.07.10.2021.PDF</i></p> <p>Dokumenti: <i>I.I.1.3.8 VSA 2 Rregullorja e studimeve cikli 2 Master - teksti integral rev EK.pdf</i></p> <p>Dokumenti: <i>I.I.1.3.9 Rregullore studimi piano.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në syllabuset e secilës lëndë të programit janë të paraqitura qartë objektivat, temat, format e vlerësimit, organizimi i mësimdhënies, literatura bazë dhe literatura plotësuese, në përputhje me VKM Nr. 41 datë 24.01.2018, i ndryshuar në VKM nr. 879, dt.18.12.2019.</p> <p>Dokumenti: <i>04 SYLLABUS PLANO DHE MESUESI.pdf</i></p> <p>Dokumenti: <i>II.1.3.1 VKM-nr.-879-dt-18.12.2019-Për-disa-ndryshime-në-VKM-nr.-41-dt-24.1.2018-Për-elementët-e-programeve-të-studimit...-1.pdf</i></p> <p>Dokumenti: <i>II.3.4.2 .VKM.5 vendim-2021-03-25-185.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” i është nënshtruar ndryshimeve mbi 20%, për t’ju përshtatur ndryshimeve të kuadrit ligjor Ky ndryshim pasqyron ndryshimin në emërtim dhe në përbërje të programit, shtimin e lëndëve me karakter psiko-pedagogjik, në mënyrë që të diplomuarit të gjejnë treg pune, jo vetëm si artistë, por edhe si mësues.</p> <p>Dokumenti: <i>II.4.3.4 Urdhri nr. 821 per riorganizim programesh studime.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, u konstatua që Departamenti i Interpretimit është përgjegjës për programin e studimit të Ciklit të dytë dhe për këtë ka hartuar Rregulloren e Programit të Studimit Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi”.</p> <p>Gjatë kontrollit të syllabuseve, u konstatua se janë të gjitha syllabuset e lëndëve me përshkrim të detajuar, duke filluar nga objektivat, qëllimi, temat javore, vlerësimi, mënyra e organizimit të lëndës, semestri, vijueshmëria, literature bazë dhe shtesë.</p> <p>Ky standard përmbushet plotësisht.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” është program koherent në lidhje me emërtimin, përmbajtjen, shpërndarjen e lëndëve dhe praktikave, të cilat mundësojnë aftësimin e studentëve për punësim si instrumentist /pianist, po ashtu edhe si mësues të instrumentit Piano.</p> <p>Në takim me studentë është evidentuar se studentët janë të punësuar edhe gjatë kohës që kryejnë studimet. Sipas të dhënave të marra nga Portali i punësimit, në harkin kohor 2019-2021, nga 14 studentë të diplomuar në instrumentin Piano, 12 prej tyre janë të punësuar.</p> <p><i>Dokumenti: I.I.1.1.2 Ligj 10247, datë 4.3.2010 Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve ndryshuar.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti: I.I.1.1.8 isced-fields-of-education-and-training-2013-en.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Lëndët /modulet, shpërndarja në vite e semestra dhe vlerësimi në kredite e orë mësimore është i qartë dhe mundëson arritjen e objektivave të programit.</p> <p><i>Dokumenti: 03 plan mesimor.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Modeli i planit mësimor mbështetet në përvojat më të mira evropiane. Struktura e programit është në përputhje me profilin e programit dhe lëndët janë adekuate për aftësimin e studentëve si instrumentistë, po ashtu përmes lëndëve pedagogjike përgatisin dhe aftësojnë studentët për aktivitetin profesional të fushës pedagogjike.</p> <p><i>Dokumenti: 03 plan mesimor.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti: 04 SYLABUS PIANO DHE MESUESI.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në programin Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi”, raporti i formimit teorik dhe praktik mundëson arritjen e objektivave formuese, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve (që rezulton të jetë rreth 85%). Nga intervista e studenteve rezulton se mobiliteti është i suksesshëm në konceptin e fuqizimit profesional, krahasimit të përvojave dhe përgatitjes së artistëve për një terren ndërkombëtar.</p> <p><i>Dokumenti: Statistikat e përgjithshme të International Credit Mobility</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve</p>	<p>Syllabuset e programit të studimit janë të përditësuara sipas kërkesave të tregut të punës, po ashtu edhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve,</p>

/moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. Ky program siguron përfitim të aftësive dhe kompetencave të duhura, për realizimin e punësimit të Alumnit të këtij programi, brenda dhe jashtë vendit.			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p><i>Dokumenti: 03 plan mesimor.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti: 04 SYLABUS PIANO DHE MESUESI.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti: I.I.I.1.2 Ligj 10247, datë 4.3.2010 Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve ndryshuar.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti: I.I.I.1.9 EQF infographic-SQ.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti: Studimi i Tregut FM me vula.PDF</i></p>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.				
Konkluzione	<p><i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit Master i Arteve në "Piano dhe Mësuesi" është hartuar në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës dhe Sistemit Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Kredive (ECTS). Ndarja e planit mësimor bëhet sipas veprimeve formuese dhe raporti midis lëndëve të formimit praktik dhe teorik është në raport të ekuilibruar. Pas përfundimit të studimeve Master, studentët janë të gatshëm për të plotësuar kërkesat e tregut.</i></p> <p><i>Ky standart përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet	Siç rezulton nga GVB, Departamenti i Interpretimit ku zhvillohet programi, është konsultuar gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit dhe ka marrë parasysh propozimet e institucioneve partnere, MAS, OJF, të të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës, me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut.

e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.							
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Fakulteti i Muzikës, Departamenti i Interpretimit mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentët të diplomuar. Kjo realizohet edhe përmes Projektit Erasmus+ CBHE me akronimin GRADUA i cili është burim i përhershëm i mbledhjes së të dhënave në mënyrë statistikore për të diplomuarit. Gjithashtu, studentët përfshihen në diskutime nëpërmjet pyetësorëve të hartuar nga NJSBC, për përmirësimin e programit të studimit. <i>Dokumenti: Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula.PDF</i>						
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Departamenti i Interpretimit ku ofrohet programi i studimit, gjatë proceseve të përmirësimit dhe përditësimit të programit, konsideron propozimet dhe zhvillimet e fundit përmes shkëmbimit të përvojave mësimore akademike të anëtarëve të personelit akademik në kuadër të mobiliteteve ERASMUS+KA107 (15 personel akademik dërguar dhe 28 personel akademik ardhur), Masterklaseve të artistëve ndërkombëtarë që zhvillohen në Fakultet, takimeve dhe dokumentave të prodhuara nga Rrjeti Global ELIA dhe AEC, etj. <i>Dokumenti: 1.1.3.3.1 Tabela 5 Marreveshjet.pdf</i>						
Konkluzione	<i>Konstatohet që Njësia Bazë, Departamenti i Interpretimit është përgjegjëse për përditësimin dhe përshtatjen e programit, proces ky që realizohet me propozimet e marra nga pedagogët dhe studentët. Studentët plotësojnë pyetësorë për programin mësimor çdo vit akademik. Databaza ALUMNI ka të dhëna të detajuara rreth studentëve të diplomuar. Departamenti ka një bashkëpunim të frytshëm në planin ndërkombëtar, të dëshmuar me projektet ndërkombëtare. <i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat	GVJ vlerëson se Programi i studimit Master i Arteve “Piano dhe Mësuesi” ka përcaktuar qartë objektivat e studimit në përputhje me objektivat madhore të Universitetit të Arteve, Fakultetit të Muzikës dhe Departamentit të Interpretimit, në përputhje me Statutin e Rregulloren e UART dhe kuadrit ligjor në fuqi.

madhorë të institucionit.	<i>Dokumenti: 1.1.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF</i> <i>Dokumenti: Rreguliorja e Universitetit të Arteve</i>		
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Fakulteti i Muzikës, Departamenti i Interpretimit administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë artistike të personelit akademik. Gjatë takimit me zyrën mësimore si dokument shtesë u paraqit edhe Marrëveshja e orëve të punës, ku paraqitet veprimtaria e mësimdhënies dhe veprimtaria artistike e personelit akademik, në përputhje me Statutin e Universitetit dhe kuadrin ligjor në fuqi. <i>Dokumenti: Statuti i Universitetit të Arteve</i> <i>Dokumenti: Ligji 80/2015</i>		
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	GVJ pas takimit me studentët, GVJ konstaton se Departamenti i Interpretimit ku ofrohet programi motivon studentët të angazhohen në aktivitete koncertale dhe projekte përmes bashkëpunimit me Orkestrën TKOBAP, OJF, po ashtu edhe përmes mobiliteteve të studentëve përmes projekteve ERASMUS +. <i>Dokumenti: Foto 60 vjetori i FM.</i>		
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	GVJ nga takimet me Dekanin dhe Sektorin e projekteve dhe aktiviteteve ka evidentuar se Universiteti ka mbështetur financiarisht aktivitetet artistike për kremtimin e 60 vjetorit të Fakultetit të Muzikës, me 60 ditë aktivitete artistike (instrumenta muzikore, baner). Sipas evidences së paraqitur nga institucioni, Fakulteti i Muzikës nuk administron në mënyrë të drejtpërdrejtë të ardhurat nga aktivitetet e ndryshme.		
Konkluzione	<i>Gjatë takimeve me Drejtuesin e Departamentit, stafin akademik dhe përfaqësuesit e Sektorit të Projekteve Artistike dhe Shkencore konstatuam se, Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti Interpretim administron këto veprimtari: mësimdhënies, artistike, kërkimore shkencore me liri akademike të personelit akademik. Studentët kanë aktivitete artistike dhe punime hulumtuese. Njësia Bazë, së bashku me pedagogun bëjnë kërkesë në Universitet të Arteve për ndihmë financiare rreth punimeve hulumtuese dhe artistike.</i> <i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Departamenti i Interpretimit mbështet grupet lëndore dhe aktivitetet koncertale.</p> <p>GVJ ka analizuar dokumentacionin në evidencë dhe ka konstatuar se pjesa më e rëndësishme e projekte artistike realizohen në bashkëpunim me strukturat e tjera, si p.sh. aktivitetet e krenimit të 60 vjetorit të Fakultetit të Muzikës.</p> <p><i>Dokumenti: Foto 60 vjetori i FM.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Njësia përgjegjëse angazhohet për realizimin e analizave, projekteve studimore duke angazhuar stafin akademik dhe studentët me mbështetje të projekteve të financuara nga fondet kombëtare e ndërkombëtare.</p> <p><i>Dokumenti: I.I.3.3.1 Tabela 5 Marreveshjet.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.3.2.5 MoU - Konservatori i Muzikes dhe Dansit Paris.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Gjatë takimit me Dekanin u paraqiten dokumente shtesë të organizimit të aktiviteteve të përvitshme si Sezoni koncertal, i cili realizohet çdo vit.</p> <p><i>Dokumenti: I.I.2.5.2 foto nga koncerte, masterclasse, takimee etj.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>GVJ vlerëson se programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun e punës kombëtar e ndërkombëtar. Studentët e programit të studimit Master i Arteve në "Piano dhe Mësuesi" janë të punësuar në institucionet publike e private brenda vendit. Ata janë gjithashtu pjesë e orkestrës për të rinj CEMAN.</p> <p><i>Dokumenti: I.I.2.5.2 foto nga koncerte, masterclasse, takimee etj.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>GVJ vlerëson se janë bërë përditësime në programin e studimit Master i Arteve "Piano dhe Mësuesi", duke u bazuar në aktet ligjore në fuqi për tregun e punës në fushën e mësimdhënies në arte.</p> <p><i>Dokumenti: Ligj Nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara"</i> <i>Dokumenti: Ligj Nr.10 357, datë 16.12.2010 "Për një shtesë në Ligjin Nr.10 171, datë 22.10.2009"</i> <i>Dokumenti: Urdhër Nr.100, dt.25.2.2022 "Miratimi i rregullores për zhvillimin e praktikave profesionale të mësuesit"</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet</p>	<p>Programi i studimit është i përputhshëm me ligjet, rregulloret e paraqitura në evidencë. Ai është në përputhje me Ligjin Nr.10 171, datë 22.10.2009, me Nr.10 357, date 16.12.2010 dhe, me Urdhër Nr.100, dt.25.2.2022, për miratimin e Rregullores për Zhvillimin e praktikave</p>

ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	profesionale të mësuesit. <i>Dokumenti: Ligji Nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara"</i> <i>Dokumenti: Urdhër Nr. 100, dt.25.2.2022 "Miratimi i Rregullores për zhvillimin e praktikave profesionale të mësuesit"</i>		
Konkluzione	<i>Bazuar në evidencat e vëna nga UART, konstatojmë që programi i studimit Master i Arteve "Piano dhe Mësuesi", ndihmon studentët në formësimin e profesionistëve kombëtar dhe ndërkombëtar. Po ashtu, i aftëson studentët në mësimdhënie në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.</i> <i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, DI, kanë të parashikuar në Statutin e UART dhe Rregulloret e brendshme, format e mëposhtme të mësimdhënies:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Leksione /Seminare b) Leksione Speciale Individuale (Piano); c) Mësim Ansambël në grup; d) Ushtrime; e) Praktikë mësimdhënie; f) Praktikë artistike. <p><i>Dokumenti: Evidenca I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.</i> <i>Dokumenti: Rregullore Mësimore e Ciklit të Dytë Master në Arte</i> <i>Dokumenti: Rregullore e Programit të Studimit Master i Arteve në "Piano dhe Mësuesi"</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Për vetë specifikën e programeve të studimit të UART, institucioni i përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve për t'u përshtatur me dinamikën e zhvillimit artistik të secilit prej tyre, si individ apo edhe në grup. Për këtë arsye përdoren:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Forma tradicionale e alternative, b) Mënyra të personalizuar studimi e kërkimi individual në kuadër të larmisë së karakteristikave të studentëve, c) Metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, sipas karakteristikave psiko-motore e të ndjeshmërisë individuale artistike të çdo studenti. <p>Nga intervistimi i studentëve, por edhe anëtarëve të Departamentit të DI, rezultoi se një nga elementët më të fortë të UART është procesi i këshillimit. Këshillimi artistik është veprimtari në shërbim të studentëve, ku pedagogët qëndrojnë në dispozicion për t'i ndihmuar në përfundimin me sukses dhe në kohën e duhur të detyrimeve akademike. Për shkak të specifikave të UART, ky proces është shumë i rëndësishëm për fuqizimin artistik, por dhe psikologjik të artistëve të rinj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me</p>	<p>Departamenti i Interpretimit e mbështet personelin akademik në sigurimin e hapësirave për studime, trajnime, shkëmbime të përvojave përmes mobilitetit me Universitetet brenda projekteve të fituara, materclass, etj.</p>

rezultatet e pritshme të të nxënit.	<i>Dokumenti: Foto nga masterclasset e profesorëve ndërkombëtarë në kuadër të Erasmus+.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga analizimi i CV të personelit akademik, GVJ vlerëson se programi i studimit ka staf të kualifikuar dhe kompetent të cilët përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies. Anëtarët e personelit akademik janë figura të njohura në botën artistike e akademike; titullarët e programit kanë një përvojë mbi 30 vjeçare, prej të cilëve 23 janë të kategorisë Profesor. Për shkak të karakterit të veçantë të programit të studimit, mësimdhënia interaktive e mentorimi i vazhdueshëm akademik janë disa nga pikat më të forta. <i>Dokumenti: I.I.1.1.16 Jeteshkrimet e PE te DI.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.2.1.3 Tabelat Personeli.pdf</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamenti i Interpretimit vlerëson format e metodat e mësimdhënies, përmes analizave vjetore të paraqitura në evidencë. Gjithashtu, në procesin e vlerësimit marrin pjesë dhe studentët, përmes vlerësimit periodik. <i>Dokumenti: I.I.3.1.14 Urdher-Rektori ANALIZA VJETORE.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.3.1.15 Analize vjetore DI.pdf</i> <i>Dokumenti: Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula.PDF</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Departamenti i Interpretimit, koordinojnë dhe bashkërendojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, ku kontribut të veçantë japin edhe Sektori mësimor, i Kurrikulave dhe i Informimit të studentëve, Sekretaria mësimore si dhe Komisioni ad-hoc për Sigurimin e Standardeve të cilësisë. <i>Dokumenti: VSA Nr_ 24, dt_ 07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funkcionimit te Njesise se Sigurimit te Brendshem te Cilesise, ne UART.pdf</i> <i>Dokumenti: VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf</i> <i>Dokumenti: Rregullore e Funkcionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART.PDF</i>
Konkluzione	<i>Nga vizita në UART, takimi me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të Sektorit mësimor dhe kurrikulës, Informimit të Studentëve si dhe Sekretarinë mësimore, si dhe evidencat</i>

	<p>e paraqitura, konstatojmë që UART, Fakulteti i Muzikës garanton procesin e të nxëniet dhe aftësimin artistik e shkencor për të arritur rezultatet e pritura.</p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se në bazë të dokumentacioneve të paraqitura në evidencë si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit të ciklit të dytë Master dhe Rregulloren e UART bëhen testimet dhe vlerësimet e njohurive. Rezultatet e testimit jepen përmes sistemit Pitagora. Të dhënat e përdorimit të sistemit dhe informacione të tjera, në lidhje me studentët publikohen periodikisht në faqen e ëëbit.</p> <p><i>Dokumenti: I.I.1.3.7 Rregullore e Universitetit te Arteve VSA_Nr.20_dt.07.10.2021.PDF</i></p> <p><i>Dokumenti: I.I.1.3.8 VSA 2 Rregullorja e studimeve cikli 2 Master - teksti integral rev EK.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti: Rregullore studimi piano.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti: III.2.1.1 Manual - studenti ne sistemin Pitagorë (2).pdf</i></p> <p><i>Dokumenti: III.3.2.1 Procesverbal mbrojtje diplome violonçel dhe mësuesi.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti: http://uart.edu.al/index.php?pgcfajq&idç585&niveliç67</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët informohen nga titullari i lëndës / modulit, në lidhje me informacione të rëndësishme për lëndën, që në orën e parë të mësimit. Prezantimi i planit mësimor i jep studentëve informacione të tilla si: programi (temat mësimore, veprimtaritë artistike), metodologjia e testimit të vlerësimit, literaturatën si dhe format e kontrollit.</p> <p><i>Dokumenti: 04 SYLABUS PIANO DHE MESUESI.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ ka analizuar Rregulloren mësimore të studimeve të ciklit të dytë të studimit, Rregulloren e programit të studimit si dhe syllabuset që janë paraqitur në evidence dhe është vërtetuar se format e kontrollit dhe vlerësimet e njohurive bëhen në disa mënyra varësisht nga specifikat e lëndës, të tilla si kontrolle teknike, mbrojtje e detyrave individuale / grup, provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, mbrojtje të temave, aktivite artistike, etj.</p>

	<p><i>Dokumenti: 06 Rregullore studimi piano.pdf</i> <i>Dokumenti: 04 SYLABUS PIANO DHE MESUESI.pdf</i> <i>Dokumenti: I.1.3.8 VSA 2 Rregullorja e studimeve cikli 2 Master - teksti integral rev EK.pdf</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Bazuar në Rregulloren e mësimore të studimeve të Ciklit të dytë Rregulloren e programit të studimit, Master i Arteve në "Piano dhe Mësuesi", si dhe planin mësimor, u konstatua që janë të paraqitura gjitha kushtet e vlerësimit të njohurive.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstaton se sipas syllabuseve të paraqitura në evidence, testimet dhe vlerësimet bëhen në mënyrë periodike gjatë gjithë vitit akademik, me forma të ndryshme të kontrollit varësisht nga specifikat e lëndës. Në bazë të këtyre specifikave, vlerësimin e lëndëve artistike bëhen me interpretim në kohë reale, me prezencë publiku. Ndërsa vlerësimet tek lëndët teorike bëhen me sekretim të emrit të studentit, për të rritur transparencën. Rezultatet e vlerësimeve publikohen në sistemin Pitagora.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p><i>Dokumenti: III.3.2.2 foto sekretimi i fletes se provimit.pdf</i> <i>Dokumenti: III.2.1.1 Manual - studenti ne sistemin Pitagorë.pdf</i> <i>Dokumenti: 04 SYLABUS PIANO DHE MESUESI.pdf</i></p>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar i lëndëve bëhet në përputhje me syllabusin dhe "Rregulloren Mësimore të Studimeve të Ciklit të Dytë Master", Rregulloren e programit Master i Arteve "Piano dhe Mësuesi", Rregullore e UART.</p> <p><i>Dokumenti: I.1.1.3.8 VSA 2 Rregullorja e studimeve cikli 2 Master - teksti integral rev EK.pdf/III.</i> <i>Dokumenti: III.3.2.1 Procesverbal mbrojtje diplome violonçel dhe mësuesi.pdf</i> <i>Dokumenti: III.5.2.1. formular per mbrojtje diplome.pdf</i></p>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale	Nga raporti i GVB, vlerësohet se vlerësimet përfundimtare shoqërohen edhe me komente përmirësimi dhe këshillimi për studentin. Për shkak

shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	të specifikave të këtij programi, procesi i vlerësimit pas performancës live, shoqërohet edhe me komente e diskutime të hapura përpara të gjithë grupit të studentëve.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	GVJ konstaton se institucioni respekton Rregullore Mësimore të Ciklit të Dytë Master dhe Kodin e Etikës në të cilat sanksionohet mos-lejimi i plagjiaturës dhe kopjimit në provime, në lëndët teorike. GVJ sugjeron që institucioni të përdorë edhe sisteme antiplagjiaturë. <i>Dokumenti: I.I.3.1.13 vsa 23.1 KODI ETIKES.pdf</i> <i>Dokumenti: Rregullore studimi piano.pdf</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sipas dokumenteve të paraqitura në evidencë, GVJ konstaton se vlerësimet e njohurive bazohen në meritë dhe paraqiten me kohë në platformën Pitagora sipas rregulloreve mësimore. <i>Dokumenti: Rregullore studimi piano.pdf</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Sipas Rregullores së studimeve të Ciklit të Dytë Master dhe sistemit Pitagora, institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit, sipas nenit 20 të rregullores. <i>Dokumenti: Rregullore studimi piano.pdf</i> <i>Dokumenti: Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.PDF</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas Rregullores Mësimore të Ciklit të Dytë Master, institucioni garanton të drejtat e studentëve për të ndjekur procedura për çdo kërkesë dhe ankimim lidhur me vlerësimin e kontrollit të dijeve, sipas procedurës së mëposhtme: a) Në përfundim të provimit dhe përpara shpalljes së rezultatit, studenti sqarohet nga komisioni për vlerësimin përfundimtar; b) Studenti kërkon rishikim të vlerësimit, në rastin kur nuk është dakort me të. Në rishikimin e provimit merr pjesë edhe Përgjegjësi i Njësisë Bazë; c) Kur studentit nuk është dakort pas rishikimit me Përgjegjësin e Departamentit i lind e drejta për t'u ankuar tek Dekani i FM. d) Dekani, mund të thërrasë për sqarime komisionin e provimit si dhe vetë studentin duke marrë vendim të formës së prerë. Vendimi i Dekanit mund të lërë në fuqi vlerësimin e komisionit, ose t'i njohë të drejtën studentit dhe të caktojë një datë tjetër për të ridhënë provimin. <i>Dokumenti: Rregullore studimi piano.pdf</i> <i>Dokumenti: Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.PDF</i>

Konkluzione	<p>Nga vizita në UART, takimi me sekretarinë mësimore, drejtuesin e Departamentit të Interpretimit, stafin akademik, studentët, u konstatua që vlerësimi i studentëve realizohet gjatë gjithë procesit dhe reflektohet në vlerësim përfundimtar, e gjithë kjo bazuar në syllabus të lëndës. Vlerësimi përfundimtar pasqyrohet në sistemin elektronik PITAGORA. Konsultimet mundësohen mes studentit dhe pedagogut për vlerësimin e marrë. Po ashtu, studenti ka të drejtë ankese në Dekanat të FM që ndjek procedurat e Rregullores së ciklit të II-të.</p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	<p>Duke u bazuar në dokumentacionin në evidencë, GVJ evidenton se programi i studimit Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” është në vijim logjik të programit të studimit Bachelor në Piano. Qëllimi i këtij programi të nivelit të dytë është të zhvillojë aftësitë profesionale-artistike dhe të zhvillojë kapacitetet pedagogjike të studentëve.</p> <p><i>Dokumenti: 03 plan mesimor.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.1.1.14 bachelor-piano-21-22.pdf</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<p>Njësia përgjegjëse që ofron programin e studimeve Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” synon që përmes lëndëve të teknologjisë informative dhe lëndëve humane të përfshira në planin mësimor të zhvillojnë aftësitë e veçanta në fushën e teknologjisë e gjuhëve të huaja. Pavarësisht statusit të veçantë të institucionit dhe specifikave të programit të studimit, nga vizita në terren u evidentua se auditoret e dedikuara për lëndët teorike, si dhe sallat e bibliotekës ishin krejtësisht të pajisura me infrastrukturën e duhur teknologjike.</p>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.	<p>Në syllabuset e lëndëve speciale janë të paraqitura kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti pas përfundimit të lëndës.</p> <p><i>Dokumenti: 04 SYLABUS PIANO DHE MESUESI.pdf</i></p>
Kriteri 4. Mësimdhënia	Në programin e studimit Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi”

<p>realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>mësimdhënia bazohet në një proces teorik e praktik, në të cilin procesi praktik zë 76.6% të ngarkesës mësimore apo 92 ECTS nga 120 ECTS gjithsej që ka i gjithë programi i nivelit të dytë.</p> <p>Po ashtu, në syllabuset e lëndëve artistike, procesi praktik mbështetet në punën individuale dhe kolektive, duke nxitur frymën e bashkëpunimit dhe diskutimit në grup. Nga sa më sipër, nxitet fryma e bashkëpunimit, krijohet një klimë e favorshme për të nxitur progresin artistik, për të qenë kompetitivë brenda vendit e për të përfitur nga mobilitet ndërkombëtare.</p> <p><i>Dokumenti: 03 plan mesimor.pdf</i> <i>Dokumenti: I.I.3.3.1 Tabela 5 Marreveshjet.pdf</i></p>		
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar GVB, personeli akademik i DI realizon interpretime dhe shpjegime të hapura për publikun mbi zhvillimet e reja të muzikës bashkëkohore, në evente koncertale, brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. Personeli akademik realizon orë dhe seminare të hapura përmes masterklaseve, të cilat zhvillohen periodikisht.</p> <p>Gjithashtu në këto aktivitete, promovohet interpretimi i studentëve përkrahë pedagogëve, duke nxitur studimin e thelluar e duke i mbështetur në aktivitete të financuara nga institucione brenda dhe jashtë shtetit.</p>		
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Gjithashtu në këto aktivitete, promovohet interpretimi i studentëve përkrahë pedagogëve, duke nxitur studimin e thelluar e duke i mbështetur në aktivitete të financuara nga institucione brenda dhe jashtë shtetit.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Konstatojmë se programi i studimit Master i Arteve "Piano dhe Mësuesi" garanton rritjen e aftësive interpretative e hulumtuese tek studentët dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale të tyre.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve



<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Institucioni ndjek procedurën standarte të kryerjes së detyrimeve përmbyllëse, duke u bazuar në nenet 30-36 të Rregullores mësimore të programit të studimit Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi”, në Rregulloren e ciklit të dytë të studimeve Master. Këto rregullore janë të publikuara në web faqen e Universitetit.</p> <p><i>Dokumenti: http://www.uart.edu.al</i> <i>Dokumenti: Rregullore studimi piano.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse të administratës informojnë studentët për datat e zhvillimit të detyrimeve përmbyllëse, si dhe i publikojnë njoftimet në faqen web të universitetit, si edhe në vende të caktuara të informimit brenda hapësirave të Fakultetit, në mbështetje të rregullores së ciklit të dytë të studimeve.</p> <p><i>Dokumenti: http://www.uart.edu.al</i> <i>Dokumenti: Rregullore studimi piano.pdf</i> <i>Dokumenti: III.5.2.1. formular per mbrojtje diplome.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit të diplomës bazohet në testimet e qëndrueshmërisë së njohurive të dhëna dhe progresit gjatë gjithë vitit akademik. Program i Diplomës organizohet në dy pjesë: me një punim teorik - tezë të shkurtër dhe programi i interpretimit që studenti performon para Komisionit si dhe publikut në sallë.</p> <p>Udhëheqësi i Diplomës Master i Arteve në “Piano dhe Mësuesi” orienton dhe ndihmon studentët Pianistë në përcaktimin e programit të diplomës duke u bazuar në Rregulloren Mësimore të Ciklit të dytë Master.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p><i>Dokumenti: Rregullore studimi piano.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nuk aplikohet për shkak të karakterit të veçantë të institucionit.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të</p>	<p>Në evidencë paraqitet modeli i vlerësimit të diplomës duke u bazuar në Rregulloren Mësimore të Ciklit të dytë Master.</p>

përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	GVJ sugjeron që modeli i paraqitur, duhej t'i përkiste programit Master i Arteve "Piano dhe Mësuesi".			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti Pianist pajiset me diplomën e studimeve, me suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, sipas Rregullores Mësimore të Ciklit të dytë Master. Gjithashtu, në përfundim të studimeve, studentit pianist i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. <i>Dokumenti: III.5.7.1. Model suplement diplome.pdf</i> <i>Dokumenti: model diplome piano.pdf</i> <i>Dokumenti: Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.PDF</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni ruan dokumentacionin e studentit dhe në përputhje me Ligjin për të dhëna personale, i cili është i mundshëm të verifikohet, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar "Për mbrojtjen e të dhënave personale". <i>Dokumenti: III.5.8.1 Ligj_Nr.9887_datë_10.3.2008_i_ndryshuar.pdf</i>			
Konkluzione	Nga vizita në UART, takimi me drejtuesin e programit të studimit, personelin akademik dhe sekretarinë mësimore, konstatoam se UART, Fakulteti i Muzikës, Departamenti i Interpretimit, ndjek procedurë të qartë të reflektimit të detyrimeve përmbyllëse të studentit dhe pajiset me Diplomë. Suplementin e diplomës së miratuar nga Senati (hartuar në përputhje me Udhëzimin e MAS Nr.11, dt. 2.4.2020) dhe përpunimin e rezultateve të studimit. <i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Institucioni siguron hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore të programit. Nga biseda me studentët, rezultojnë se mjediset janë të mjaftueshme për realizimin e orëve mësimore dhe të praktikës. Institucioni siguron mjedise specifike për orët e mësimin individual, mjedise për mësim në grupe të vogla, si dhe auditore të pajisura me infrastrukturë digjitale, për zhvillimin e lëndëve me karakter psiko-

	pedagogjik. Gjatë vizitës së hapësirave, GVJ konstatoi se ka hapësira të mjaftueshme dhe adekuate për mësim dhe ushtrime individuale të studentëve. <i>Dokumenti: - Vizita e GJV-së në Universitetin e Arteve</i>								
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Për shkak të specifikave që ka programi, ky kriter nuk mund të aplikohet në programet e fushës së interpretimit muzikor.								
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nuk aplikohet, sepse praktikat maten me kredite, të parashikuara në përputhje me planin mësimor. <i>Dokumenti: 03 plan mesimor.pdf</i> <i>Dokumenti: 04 SYLABUS PIANO DHE MESUESI.pdf</i>								
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, rezulton se institucioni siguron hapësira të mjaftueshme.</i> <i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në RVB e programit të studimit si dhe gjatë vizitës në institucion, për tre vitet e fundit akademike (2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022), konstatohet që, personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e këtij program studimi, respekton kriteret ligjore në fuqi, si dhe ofron ekspertizën e nevojshme lidhur me mbarëvajtjen cilësore të procesit të mësimdhënies.</p> <p>Sa më sipër, për vitin akademik 2019-2020, janë angazhuar 21 personel akademik, nga të cilët 15 personel akademik efektiv (7 Prof., 4 Prof.Asoc, 1 Doktor dhe 3 MA) dhe 6 personel efektiv me kontratë (1 Prof., 2 Doktor dhe 3 MA).</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, janë angazhuar 26 personel akademik, nga të cilët 19 personel akademik efektiv (8 Prof., 4 Prof.Asoc, 2 Doktor dhe 5 MA) dhe 7 personel efektiv me kontratë (1 Prof., 2 Doktor dhe 4 MA).</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022, janë angazhuar 20 personel akademik, nga të cilët 18 personel akademik efektiv (7 Prof., 4 Prof.Asoc, 3 Doktor dhe 4 MA) dhe 2 personel efektiv me kontratë (2 Doktor).</p> <p>Bazuar në të dhënat e mësipërme evidentohet plotësimi i kuadrit ligjor lidhur me ekspertizën dhe nivelin profesional në procesin mësimdhënës në një program të ciklit të dytë, Bazuar në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, pika 3/c Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi”, rezulton se raporti PAK dhe PAE, për vitin akademik 2021-2022, është 18-2 (90%-10%).</p> <p><i>Evidenca I.I.2.1.3 Tabelat Personeli. Tabela 7.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Konstatuam se, personeli akademik me kohë të plotë, pranë Departamentit të Interpretimit (DI), mbulon ngarkesën dhe zhvillon aktivitetin mësimdhënës, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe konform Udhëzimit nr. 29, dt. 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”.</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p><i>Evidenca I.I.2.1.3 Tabelat Personeli. Tabela 4.</i></p> <p>Bazuar në takimin me Drejtorinë e burimeve njerëzore konstatoam se, institucioni derdh rregullisht kontributet shoqërore dhe shëndetësore të stafit akademik dhe të studentëve që zhvillojnë praktikat mësimore pranë shkollave përkatëse.</p> <p>Gjithashtu, në takimin me personelin akademik, të programit të studimit, evidentohet qëndrueshmëri kontraktuale, si dhe korrektësi në pagesat e kryera, bazuar në legjislacionin në fuqi.</p> <p><i>Evidenca VI.I.3.3. Model kopje listpagese me sigurimet e paguara.</i> <i>Evidenca I.I.1.1.5 Urdher Nr.100 dt.25.2.2022 Rregullorja për zhvillimin e praktikave profesional te mesuesit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Konstatoam se, vlerësimi për përzgjedhjen e personelit realizohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, bazuar në propozimin e departamentit, e cila përditëson në mënyrë të vazhdueshme të dhëna që lidhen me aktivitetin kërkimor të stafit akademik, CV e tyre akademike, kontratat, formularët e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës mësimore.</p> <p>Referuar RVB-së, resulton se, Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DI. Bazuar në kuadrin ligjor ajo arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK, si dhe marrëveshjet kontraktuale të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit.</p> <p><i>Evidenca I.I.2.1.3. Tabela personeli per programin piano dhe mësuesi.</i> <i>Evidenca VI.I.3.2. Model draft kontrate të stajlt akademik me kohe të pjeseshme</i> <i>Evidenca VI.I.4.1. Model dosje per rekrutim personeli akademik</i> <i>Evidenca VI.I.3.1. Kopje e nji modeli marreveshje per kohen e punes vjetore të personelit akademtk</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB, dhe vizitën në institucion, konstatoam se, Fakulteti i Muzikës ka punonjës ndihmës për realizimin e këtij programi studimi në përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike mësimore si dhe në realizimin e aktiviteteve artistike dhe mësimore, për vetë natyrën specifike të këtij programi studimi, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krye Sekretare - Sekretare e Kurikulës dhe Marrëdhënie me Studentët - Punonjëse shërvimi - Specialist laborant <p><i>Evidenca I.I.3.1.12 VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i></p>


<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe takimet fizike, konstatuam se, institucioni mbledh dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik sipas organigramës së UART, në lidhje me strukturën analitike të FM, në rang njësie dhe personelin përkatës. Departamenti, mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program dhe personat përgjegjës për organizimin e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.</i> <i>Evidenca I.I.2.1.4 Organigrama FM Organigrama FM (2).</i> <i>Evidenca I.I.2.1.3 Tabelat Personeli. Tabela 7.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni "UART" ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me kompani dhe ZVA dhe shkolla të arsimit parauniversitar në të gjithë vendin. Kryesisht, FM ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me Zyrat arsimore, ku shihet se janë të përcaktuara qartë detyrat e secilit aktor. UART merr përsipër: deklarin e studentëve praktikantë lidhur me sigurimet shëndetësore, sigurimin e pedagogut mentor, ndihmën e nevojshme për studentët praktikantë, ndjekjen e punës së studentëve dhe vlerësimin e studentëve për paketën e praktikës.</p> <p>Zyrat arsimore, marrin përsipër, mundësimin e zhvillimit të praktikave për studentët, sipas shkollave dhe nivelit të tyre të studimit, si dhe në dhënien e mendimeve për vlerësimin e studentëve praktikantë.</p> <p><i>Evidenca I.I.3.3.2 Marrëveshje FM me ZVA Vlore.</i> <i>Evidenca I.I.1.1.5 Urdher-Nr.100-dt.25.2.2022 Rregullorja për zhvillimin e-praktikave-profesional-te-mesuesit.</i> <i>Evidenca VI.I.1.1. Model vleresimi i praktikës profesionale</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Realizimi i praktikave mësimore, zhvillohet sipas një protokollit të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritisë.</p> <p>Formularët dhe dosja e praktikës janë pjesë përbërëse e vlerësimit final të studentit, si dhe paraqesin në mënyrë të qartë veprimtaritë, orët, mënyrat dhe modelet e aplikuara përgjatë zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca I.I.1.1.5 Urdher-Nr.100-dt.25.2.2022 Rregullorja për zhvillimin e-praktikave-profesional-te-mesuesit.</i> <i>Evidenca VI.I.1.1. Model vleresimi i praktikës profesionale</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, qartësisht të pasqyruara, GVJ, konstaton se, personeli akademik efektiv dhe me</i></p>

	<p><i>kontratë, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit. Konstatuam gjithashtu, se zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DI dhe se departamenti, mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program. Konstatuam se realizimi i praktikave mësimore, zhvillohet sipas një protokollit të mirë-përcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritës.</i></p> <p><i>Përsa me sipër, evidentojmë përpunueshmëri të plotë në zbatimin e standardeve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara, pra ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga vizita e mjediseve të institucionit konstatuam se, për shkak të specificitetit që ky program studimi ka, kurset e këtij program studimi, zhvillohen në kampusin universitar, si dhe infrastruktura e universitetit përmban mjedise me përmasa të mëdha dhe me kushte të mira fizike për zhvillimin e jo vetëm të mësimdhënies, por dhe të veprimtarive artistike dhe kërkimore shkencore.</p> <p>Disa nga mjediset më rëndësishme për zhvillimin e procesit të mësimdhënies, por edhe të veprimtarive artistike dhe kërkimore shkencore janë klasat e pianos, kati i II, të rikonstruata.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatuam se, disa nga mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, biblioteka janë të pajisura me mjete e duhura elektronike dhe teknologjike, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, si dhe veprimtaritë artistike përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënies.</p> <p>Institucioni, ka kapacitet infrastrukturor dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke përmbushur kështu standardet e duhura për çdo student.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit,</p>	<p>Nga vizita e mjediseve, konstatuam se, klasat mësimore, studiot dhe laboratorët janë të pajisur me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor (lexhio, karrike, piano, tabela etj).</p>



<p>përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, konstatuam se mjediset mësimore si zyra, studiot, klasat, laboratorët, sallat e performancës, janë të pajisuara me mjetet e nevojshme fizike, teknike dhe teknologjike, të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të kurseve që ofron ky program studimi për aftësimin teorik, praktik si dhe artistik.</p> <p><i>Evidenca VI.2.4.3 - Analize vjetore e FM.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatuam se infrastruktura qëndrore e shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit në Institucion përbëhet nga 6 pajisje server dhe 3 njësi netëork storage. Aktualisht, në institucion janë të instaluar mbi 50 pajisje kompjuterike të ndërlidhjes së rrjetit kompjuterik në tërësi, të përbërë nga sëitch-e, media converter-a, router, fireëall, transmetues me valë të brendshme dhe të jashtëm.</p> <p>Rezulton se, FM disponon dy laboratorë të pajisur me kompjuter dhe programe profesionale. Njëri nga labororet disponon 5 kompjutera të pajisur me programin Sibelius (për notizimin digjital) dhe Steinbeig Cubase (për regjistrimin dhe përpunimin audio).</p> <p>Rezulton, gjithashtu, se pranë Bibliotekës së UART ndodhet laborator i informatikës, i pajisur me softuerët përkatës në mënyrë që të t'i shërbejë sa më mirë programit mësimor me një kapacitet afërsisht 40 vendesh. Ai është në parametra të mirë për realizimin e nevojave të programit të studimit në lidhje me përdorimin e teknologjisë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Laboratori, rezulton se shërben për zhvillimin e detyrave dhe projekteve të kursit të studentëve, por edhe për aktivitete të ndryshme nga vetë departamenti. Një punonjës i IT-së është në dispozicion të mirëmbajtjes së laboratorit dhe rrjetit kompjuterik të UART, gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore, si dhe ofron asistencë teknike për studentët dhe stafin akademik.</p> <p><i>Evidenca Infrastruktura IT e UART.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtari të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit</p>	<p>Konfirmojmë që, institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore parauniversitare, për realizimin e praktikave mësimore të studentëve të këtij program studimi. Me mundësitë dhe infrastrukturën që ka, UART, ka kapacitete të mjaftueshme për të organizuar veprimtari praktike dhe artistike si dhe veprimtari të posaçme në bashkëpunim me institucione të tjera kulturore brenda dhe jashtë vendit si dhe institucione homologe jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca I.1.1.1.5 Urdher-Nr.100-dt.25.2.2022 Rregullorja për zhvillimin e-praktikave-profesional-te-mesuesit.</i></p> <p><i>Evidenca VI.1.1.1. Model vleresimi i praktikës profesionale</i></p>

në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.	<i>Evidenca I.I.3.3.1 Tabela 5 Marreveshjet.</i>		
Konkluzione	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe asaj artistike.</i></p> <p><i>Gjithashtu, konstatojmë se institucioni ka kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke përbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse në shërbim të programit të studimit plotëson të gjitha kriteret e vlefshmërisë dhe përdorimit. Ajo gjendet si fizikisht, ashtu edhe në rrugë elektronike duke garantuar kështu një shfrytëzim të mirë të saj për realizimin e detyrave dhe projekteve të kursit si dhe realizimit e aktiviteteve të ndryshme artistike.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion konstatojm se, literatura për realizimin e këtij program studimi përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Literatura bazë; - Literatura ndihmëse; - Periodik të huaj; - Periodik shqiptarë; - Enciklopedi, diksionerefjalor; - Dorëshkrime të kompozitorëve shqiptarë; - Koleksione periodike në fushat e artit; - Punime teorike universitare dhe pasuniversitare të studentëve dhe pedagogëve; - Monografi shkencore të fushave të ndryshe mbi muzikën, letërsinë, artin dhe kulturën në gjuhën shqipe.

	<p><i>Evidenca IV.3.2.1 Katalogu i partiturave te dhuruara BSHUA nga shtepia botuese.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Konstatohet se, njësia kryesore me propozim nga njësia bazë çdo fillim viti akademik paraqet listën e kërkesave të titujve për pasurimin e fondit të titujve në shërbim të realizimit të programeve të studimit që ofron.</p> <p>Rezulton se janë bërë përditësimet respektive në katalogun online të BSHUA lidhur me partet dhe partiturat e Edicionit Henle Verlag.</p> <p><i>Evidenca 3.15 Lista e titujve FM në Bibliotekën UART.</i></p> <p><i>Evidenca IV.3.2.1 Katalogu i partiturave te dhuruara BSHUA nga shtepia botuese.</i></p> <p><i>Evidenca IV. 3.2.1 Katalogu i partiturave te dhuruara BSHUJ nga shtepia botuese gjermane Henle Verlag</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatoam se, biblioteka është e konceptuar në disa mjedise të ndërlidhura së bashku. Përveç mjedisit ku është vendosur fondi i librave, gjenden gjithashtu edhe dy salla laboratorë si; Salla e fondit të hapur dhe Media Library të pajisura me infrastrukturë rrjeti kompjuterik.</p> <p>Në ambjentet e bibliotekës ndodhet gjithashtu salla “Multimedia”, e cila është e pajisur me 20 kompjutera që kanë akses në internet të pajisur me softëare specifik në mbështetje të punës individuale studimore.</p> <p>Shërbimi elektronik i bibliotekës ofrohet nëpërmjet dy sistemeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sistemi i menaxhimit përmes të cilit biblioteka kryen katalogimin dhe shfaqjen përmes shfletuesit publik (OPAC) për audiencën e gjërë. • Sistemi i arkivit digjital ku përdoruesit mund të shfletojnë materialet elektronike. <p><i>Evidenca Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale.</i></p> <p><i>Evidenca Lista e pajisjeve të Bibliotekës së UART.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive</p>	<p>Konstatohet se, Biblioteka është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra apo revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës të programit të studimit.</p> <p>Biblioteka e UART luan rolin e një biblioteke speciale për të gjithë fishat e artit në Shqipëri.</p> <p>Bazuar në vizitën në institucion, rezulton se numri i teksteve përfshin</p>

<p>mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>libra teorik të artin skenik, regji, skenografi, kostumografi, filmi, koreografi; koleksionin e dramës: drama, përkthime, komedi, periodikë si dhe letërsi shqip dhe huaj dhe shqipe si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 45.000 libra, albume, partitura & parte; • 40.000 File (audio/ pdf) – muzike e huaj dhe shqiptare ; • 1000 doreshkrime; • 897 perkthim dhe adaptim; • 400 drama te perkthyer ne shqip • 68 tituj (periodik i huaj); • 42 tituj (periodiku shqiptare); • 20 Titles (gazeta). • Fondi referues – enciklopedi, diksionere, tituj 150 +100 fjalor • Letersia shqipe - 3040 tituj • Letersia e huaj – 2646 tituj • Drama, perkthime teorike, ne shaptilograf, printime - 1000 tituj • Estetika, filozofi, psikologji, sociologji – 200 tituj • Seriale – 1455 tituj • Teoria e Drame, regjise - 700 tituj • Histori teatri - 308 tituj • Filmi – 460 tituj • Teatri – 409 tituj • Koreografi - 300 tituj <p>Një vend të rëndësishëm në fondin e saj zënë fondet speciale si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1000 dorëshkrime të kompozitorëve shqiptare. • 3000 koleksione periodike në fushat e artit. • 1500 punime teorike universitare dhe pasuniversitare • 1400 fotokopje të parteve dhe partiturave të formacioneve orkestrale. • 750 tituj monografi shkencore të fushave të ndryshe mbi muzikën, letërsinë, artin dhe kulturën në gjuhën shqipe. <p>Rekomandohet shtimi i fondit të teksteve fizike dhe elektronike në fushën e edukimit (literature bazë dhe e këshillueshme) për</p>
--	--

	<p>plotësimin e nevojave të studenteve në realizimin e leksioneve, detyrave dhe projekteve të kurseve me karakter psiko-pedagogjik që ky program studimi ofron për formimin e mësuesve të ardhshëm.</p> <p><i>Evidenca Rregullorja e funksionimit të bibliotekës UART.</i> <i>Evidenca IV.3.2.1 Katalogu i partiturave të dhuruara BSHUA nga shtepia botuese.</i> <i>Evidenca IV.3.2.1 Katalogu i partiturave të dhuruara BSHUA nga shtepia botuese (2).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatoam se, menaxhimi i librave të bibliotekës është i realizuar nëpërmjet skedarëve dhe gjithashtu nëpërmjet platformës online për të krijuar kushte për akses të shpejtë, të barabartë e pa pagesë për studentët.</p> <p>Rezulton se, periodiku retrospektive - kërkimi bëhet në katalogun manual dhe shërbehet në fondin e mbyllur për t'u studiuar në sallën e leximit me fonde të hapura përgjatë orarit 8:00 – 19:00.</p> <p>Ndërsa periodiku koherent, rekorde bibliografike me të dhëna të hollësishme mbi përmbajtjen, kërkimi bëhet online, kurse shërbim ofrohet në fondi i mbyllur dhe shfletohet në sallën e leximit me fonde të hapura përgjatë orarit 8:00 – 19:00.</p> <p><i>Evidenca IV.3.2.1 Katalogu i partiturave të dhuruara BSHUA nga shtepia botuese.</i> <i>Evidenca IV.3.2.1 Katalogu i partiturave të dhuruara BSHUA nga shtepia botuese (2).</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Rezulton se, institucioni ka krijuar mundësi për aksesim e studentëve në platformën on-line të bibliotekës ku mund të paraqesin kërkesat e tyre për shfrytëzimin e librave fizik dhe digjital. Institucioni i ofron studentëve mundësi aksesimi nëpërmjet abonimit në revista shkencore online si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Years 2007 – Grover Music; • Years 2008 -2013 - Cambridge journals online; Oxford English Dictionary online; • Oxford reference online; • Years 2012 – 2013 - Alexander Street Pres; Jstor; Muse; Eiley; • AKSH – Ebscohost <p>Hyrje e lirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ IMSLP – Petrucci Music Library. http://imslp.org/ ▪ ILSan – Il sistema Archivistico Nazionale. http:// san.beniculturali.it ▪ Culturetheque Instituti Francais www.culturetheque.com si dhe nëpërmjet katalogut online të

	<p>Bibliotekës universitare uart.edu.al/katalog_biblio dhe arkivës dixhitale të Bibliotekës së Universitetit të Arteve arkiv.uart.edu.al.</p> <p><i>Evidenca Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale.</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, konstatuam se, Biblioteka funksionon nëpërmjet Regjistrimit themeltar të inventarit të koleksioneve bibliotekare, i cili është dokumenti bazë që pasqyron të gjitha materialet bibliotekare që kanë hyrë në bibliotekë që në krijimin e saj në mënyrë kronologjike. Regjistri i inventarit është dokument mbi bazën e të cilit bëhet inventari i bibliotekës. Në të rregjistrohet çdo njësi që hyn në bibliotekë dhe merr një numër që e identifikon atë si njësi unike midis tërë koleksionit të bibliotekës.</p> <p>Biblioteka ka vënë në dispozicion të studentëve aksesimin nëpërmjet katalogut online të Bibliotekës së Universitetit të Arteve uart.edu.al/katalog_biblio dhe arkivës dixhitale të Bibliotekës së Universitetit të Arteve arkiv.uart.edu.al si dhe oraret e shërbimit, për të qënë në dispozicion të nevojave të studentëve. Biblioteka punon përgjatë orarit 8:00 – 19:00.</p> <p><i>Evidenca Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale.</i></p> <p><i>Evidenca IV.3.2.1 Katalogu i partiturave të dhuruara BSHUA nga shtëpia botuese.</i></p> <p><i>Evidenca IV.3.2.1 Katalogu i partiturave të dhuruara BSHUA nga shtëpia botuese (2).</i></p> <p><i>Evidenca Lista e pajisjeve të Bibliotekës së UART.</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatuam se, biblioteka dhe njësitë bazë kanë një komunikim të vazhdueshëm për pasurimin e fondit fizik dhe elektronik të fondit të titujve. Njësia kryesore me propozim nga njësia bazë çdo fillim viti akademik paraqet listën e kërkesave të titujve për pasurimin e fondit të titujve në shërbim të realizimit të programeve të studimit që ofron.</p> <p>Biblioteka bën përditësime periodike për shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit nëpërmjet Arkivës Dixhitale të BSHUA, nga ku rezulton se, për vitin akademik 2021-2022 kanë shfrytëzuar fondit online të bibliotekës 1073 përdorues, nga të cilët 704 nga Shqipëria, 148 nga Kosova, 46 nga USA, 26 nga Italia etj.</p> <p><i>Evidenca DSPACE ANALYTICS 20220101-20220701 - Statistika të aksesit të Bibliotekës së UART.</i></p>

tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.									
Konkluzione	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se, Biblioteka e UART ka një fond shumë të pasur fizik dhe elektronik me tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj si dhe dorëshkrime, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës të programit të studimit, por vërehet një mungesë fondi specifik dedikuar kurseve të karakter psiko-pedagogjik që ofrohen në të gjitha programet e ciklit të dytë të studimeve që ofrohen në këtë institucion, si rrjedhojë: Rekomandohet shtimi i fondit të teksteve fizik dhe elektronik në fushën e edukimit (literature bazë dhe e këshillueshme) për plotësimin e nevojave të studenteve në realizimin e leksioneve, detyrave dhe projekteve të kurseve me karakter psiko-pedagogjik që ky program studimi ofron për formimin e mësuesve të ardhshëm.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Konstatojmë se UART, përdor sistemin PITAGORA.</p> <p>Gjithashtu, konstatojmë se sekretaria mësimore disponon statistika vjetore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit; • të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik; • të dhëna për transferimet dhe ç' regjistrimet; • të dhëna për ecurinë akademike të studentit; • numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik; • të dhënat e studentëve që diplomohen. <p><i>Evidenca III.2.1.1 Manual - studenti ne sistemin Pitagorë.</i></p> <p><i>Evidenca III.2.1.1. Manul_Pedagogu ne sistemin Pitagore.</i></p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i	Rezulton se institucioni disponon informacion të plotë për aktivitetin

<p>menaxhimit aDIinistron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit aDIministrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>mësimor dhe atë kërkimor-shkencor të personelit akademik.</p> <p>Ndërsa në listën e marrëveshjeve në funksion të programit të studimit shprehet qartë aktiviteti që insitucioni ka, në rang njësie kryesore dhe njësie bazë me partnerët të cilët janë të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi.</p> <p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore, disponon dhe arkivon dokumentacionin për personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Ndërsa Departamenti monitoron dhe nxit aktivitetin mësimor dhe kërkimor-shkencor.</p> <p><i>Evidenca Aktivitetet e Stafit, Studenteve dhe Alumni te FM.</i> <i>Evidenca I.I.2.1.3 Tabelat Personeli. Tabela 7.</i> <i>Evidenca Struktura administrative dhe ndihmës akademike në Fakultetin e Muzikës përbëhet si më poshtë vijon.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi me sekretarinë mësimore, konstatoam se ajo ruan të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në formatin e Regjistrit Themeltar të Studentëve dhe Regjistrin e Diplomimit.</p> <p><i>Evidenca Rregullore e Funksionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART.</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit PITAGORA, rezulton se institucioni menaxhon sistemin e regjistrimeve, kurrikulën, grafikun e provimeve online, hedhjen dhe ruajtjen e vlerësimit, fazën e paradiplomimit dhe diplomimit. Studentëve u jepen të dhënat e aksesit të llogarive individuale për regjistrimin përfundimtar në mënyrë që ata të aksesojnë atë në çdo kohë, nga çdo pajisje që ka lidhje interneti. Sekretaria mësimore mban në sistem edhe të dhëna personale të studentëve si numra telefoni, adresa emaili dhe ruan kontakte të vazhdueshëm me studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti, etj.</p> <p><i>Evidenca VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i> <i>Evidenca Rregullore e Funksionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART.</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UART dhe DI, si dhe të dhënave të evidentuara në institucion, rezulton se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, përmbushjen e zhvillimit të</p>

dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	leksioneve dhe aktiviteteve të tjera mësimore. <i>Evidenca I.I.I.3.7 Rregullore e Universitetit të Arteve Nr.20 dt.07.10.2021.</i> <i>Evidenca VSA_45 Rregullore e Departamentit Interpretim FM.</i>								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Konfirmojmë që, në faqen zyrtare të internetit të UART janë publikuar të dhëna në lidhje me strukturën organizative, stafin akademik, veprimtaritë, bazën ligjore, kurrikulat dhe kalendarin akademik, kriteret e përzgjedhjes së studentëve si dhe njoftimet të ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademike të UART, në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. <i>http://www.uart.edu.al/index.php?langç1</i> <i>http://www.uart.edu.al/index.php?langç2</i>								
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet sistemit Pitagora, duke administruar të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Konstatojmë, gjithashtu, se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, në faqen e tyre zyrtare të web-it në gjuhën shqipe dhe atë angleze, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i> <i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në RVB, institucioni harton çdo fillim viti buxhetin financiar i cili, pasi hartohet nga Administratori, miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, ku deklarohen kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimi i mbulimit financiar për programet e studimit dhe njësinë bazë. UART, harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e

	<p>vendosura. Në to përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, etj.</p> <p><i>Evidenca IV.5.2.2 Plan buxheti i financimit te programeve te studimit. Evidenca Vendim Senati dhe Bordit per shperndarjen e Grantit (planbuxheti).</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në</p>	<p>Konfirmojmë që, institucioni ka paraqitur një plan financiar për këtë program studimi. Ndersa plani i financimit të dërguar për këtë program studimi specifikon shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, gjithashtu shpenzimet për fondin e bibliotekës, si dhe shërbimeve të lidhura me procesin mësimor dhe shkencor të Departamentit.</p> <p><i>Evidenca Pasqyrimi financiar vjetor UART. Evidenca IV.5.2.2 Plan buxheti i financimit te programeve te studimit. Evidenca Vendim Senati dhe Bordit per shperndarjen e Grantit (planbuxheti).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Konstatuam që, UART, nuk i është nënshtruar një auditimi financiar, për shkak se disponon një strukturë të posaçme për realizimin e Auditit të brendshëm, siç parashikon VKM Nr. 83, Datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Konstatuam se, në mbyllje të çdo viti kalendarik, institucioni dokumenton raportin financiar për 1 vit kalendarik dhe konstatuam se në bilancin e vënë në dispozicion, pasqyrohen të gjitha të dhënat përse i përket realizimit të buxhetit, si dhe shpenzimeve të kryera.</p> <p><i>Evidenca Pasqyrimi financiar vjetor UART. Evidenca IV.5.2.2 Plan buxheti i financimit te programeve te studimit. Evidenca Vendim Senati dhe Bordit per shperndarjen e Grantit (planbuxheti).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni</p>	<p>Konstatuam se bilanci i vënë në dispozicion nga institucioni dëshmon se UART garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, për këtë program studimi nëpërmjet aplikimit në projekte të ndryshme fitimprurëse.</p> <p><i>Evidenca Pasqyrimi financiar vjetor UART.</i></p>

planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	<i>Evidenca IV.5.2.2 Plan buxheti i financimit te programeve te studimit. Evidenca Vendim Senati dhe Bordit per shperndarjen e Grantit (planbuxheti).</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, ku përfshihen kostot për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i> <i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Në përputhje me legjislacionin në fuqi, UART ka hartuar statutin dhe rregulloren e universitetit, të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikën dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Diplomimi i studentëve bëhet në përputhje me rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.</i> <i>Evidenca I.I.1.3.7 Rregullore e Universitetit te Arteve VSA Nr.20 dt.07.10.2021.</i> <i>Evidenca VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i> <i>Evidenca I.I.1.3.9 Rregullore studimi piano.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet që institucioni ka ngritur komisionet përkatëse, pranë departamentit, ku nëpërmjet Rregullores së ciklit të dytë Master ka hartuar politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë në këtë program studimi. Konfirmohet që procedurat dhe kriteret e pranimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikën e hartuar nga institucioni.</p> <p><i>Evidenca I.I.1.3.9 Rregullore studimi piano.</i> <i>Evidenca I.I.1.3.8 VSA 2 Rregullorja e studimeve cikli 2 Master - teksti integral rev EK.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve</p>	<p>Rezulton se përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni me propozim nga DI dhe miratim nga Senati Akademik, harton kriteret dhe procedurat për hyrjen në programin e studimit "Master i Arteve në Piano dhe Mësuesi", duke garantuar shance të barabarta për të gjithë kandidatët nëpërmjet shpërndarjes së kuotave për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare si dhe personat me aftësi të veçanta.</p> <p><i>Evidenca I.I.3.1.6 Per ngritjen e komisionin e ciklit te dyte te programit te dyte.</i></p>



përkatëse.	<p><i>Evidenca 2.2 I.I.1.3.8 VSA 2 Rregullorja e studimeve cikli 2 Master - teksti integral rev EK.</i></p> <p><i>Evidenca I.I.3.1.5 rregulloret dhe kriteret 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Konstatohet se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron UART, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online.</p> <p>UART, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që ofron.</p> <p>Konstatohet që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të publikuara në faqen e internetit të UART, sipas fakulteteve përkatëse:</p> <p>(http://www.uart.edu.al/index.php?pgcfaqe&idç5&niveliç9)</p> <p>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e ciklit të II të studimit Master, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin. • Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit tyre në programin e studimit. • Kurrikulën e Programit të Studimit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi • Rregullorja e Programit të Studimit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe prapen e kalimit nga njëri vit në tjetrin. <p>Gjithashtu, nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe prapen e kalimit të vitit akademik dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin.</p> <p>Konstatohet se bazuar në Rregulloren e UART, në Rregulloren e programit të studimit, Rregulloren e ciklit të II të studimit Master si dhe syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës</p>



	<p>janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi.</p> <p><i>Evidenca I.I.1.3.8 VSA 2 Rregullorja e studimeve cikli 2 Master - teksti integral rev EK.</i> <i>Evidenca 04 SYLABUS PIANO DHE MESUESI.</i> <i>Evidenca 03 plan mësuesor.</i> <i>Evidenca I.I.3.1.5 rregulloret dhe kriteret 2022-2023.</i> <i>Evidenca I.I.1.3.7 Rregullore e Universitetit të Arteve VSA Nr.20 dt.07.10.2021.</i> <i>Evidenca I.I.1.3.9 Rregullore studimi piano.</i> <i>Evidenca I.I.1.3.9 Rregullore studimi piano.</i> <i>Evidenca I.I.1.3.8 VSA 2 Rregullorja e studimeve cikli 2 Master - teksti integral rev EK.</i> <i>Evidenca 04 SYLABUS PIANO DHE MESUESI.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Rezulton se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi.</p> <p>Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të UART, gjenden në çdo kohë plan programet për çdo program studimi: http://uart.edu.al/index.php?pgcfaqe&idç193&niveliç70</p> <p>(http://uart.edu.al/index.php?pgcfaqe&idç549&niveliç124) <i>Evidenca II.1.6.4 Rregulloret dhe kriteret MASTER 2022-2023 FM.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Konstatohet se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit për programet e studimit që UART ofron, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online.</p> <p>UART, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që ofron.</p> <p><i>Evidenca II.1.6.4 Rregulloret dhe kriteret MASTER 2022-2023 FM.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Rezulton se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi.</p> <p>Plani i programit të studimit i bëhet i ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të UART, gjendet në çdo kohë Rregulloret dhe Kriteret për pranimin e studenteve</p> <p>(http://uart.edu.al/media/Rregulloret%20dhe%20kriteret%20MASTER%202022-2023%20FM.pdf) (http://www.uart.edu.al/)</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave</p>	<p>UART ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë të komunitetit Romë, Ballkano dhe Egjiptianë si dhe jep bursa për shtresat</p>

<p>për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>në nevojë dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke i publikuar ato në faqen e internetit: http://uart.edu.al/index.php?idç1138</p> <p><i>Evidenca II.1.6.5 VKM Nr 780, dt. 26.12. 2018 “ Për përcaktimin e kategorive të individëve për ulje tarife”</i> <i>Evidenca VKM Nr. 251 dt. 27.03.2020 për një ndryshim në VKM nr. 269 dt. 29.03.2017 për përjashtimin nga pagesa të studentëve; Romë-Ballkano –Egjiptianë.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron UART, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online në faqen zyrtare të web-it.</i> <i>Gjithashtu, konstatohet se UART, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për studentët si dhe ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë duke dhënë bursa për to dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	

<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Konstatohet që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të publikuara në faqen e internetit të UART, sipas fakulteteve përkatëse.</p> <p>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e ciklit të II të studimit Master, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin. • Rregullorja e Programit të Studimit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Gjithashtu, nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe

	<p>pragun e kalimit të vitit akademik dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit tyre në programin e studimit. • Kurrikulën e Programit të Studimit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi <p><i>(Evidenca 03 Planet Mesimore FM)</i> http://uart.edu.al/media/master-piano-21-22.pdf</p> <p><i>Evidenca I.I.1.3.8 VSA 2 Rregullorja e studimeve cikli 2 Master - teksti integral rev EK.</i> <i>Evidenca I.I.1.3.9 Rregullore studimi piano.</i></p> <p><i>Evidenca 04 SYLABUS PIANO DHE MESUESI.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Nëpërmjet Rregullores se Programit të Studimit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritë mesimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mesimore, vlerësimin dhe diplomimin.</p> <p><i>Evidenca I.I.1.3.9 Rregullore studimi piano.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se bazuar në Rregulloren e UART, në Rregulloren e ciklit të II të studimit Master dhe syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi.</p> <p><i>Evidenca I.I.1.3.7 Rregullore e Universitetit te Arteve VSA Nr.20 dt.07.10.2021.</i></p> <p><i>Evidenca I.I.1.3.9 Rregullore studimi piano.</i></p> <p><i>Evidenca I.I.1.3.8 VSA 2 Rregullorja e studimeve cikli 2 Master - teksti integral rev EK.</i></p> <p><i>Evidenca 04 SYLABUS PIANO DHE MESUESI.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit “Master i Arteve Piano dhe Mësuesi”, janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e</p>

lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	diplomimit në këtë program studimi. <i>Evidenca I.I.1.3.9 Rregullore studimi piano.</i>		
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion, u informuam se DI, në fillim të vitit të parë të studimeve në bashkëpunim me Këshillimin e Karrierës dhe Alumni, organizon javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. <i>Evidenca VSA Nr_21, dt_07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funkcionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit te Studenteve, Keshillimit te Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i>		
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe evidancat, konstatohet që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban programi i studimit i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Nëpërmjet Rregullores se Programit të Studimit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi, ku përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik, kriteret e aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre si dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës.</i> <i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Konstatohet që studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës. Komunikim i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore realizohet nëpërmjet Sistemit Petagora. Aty studenti mund të aksesojë në çdo kohë informacionin e nevojshëm në lidhje me format e vlerësimit për secilën lende, informacion në lidhje

	<p>me frekuentimin, grafikun e provimeve, auditorët, etj.</p> <p><i>Evidenca III.2.1.1 Manual - studenti ne sistemin Pitagorë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Rezulton se në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale si Rregullorja e Programit të Studimit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe prapun e kalimit nga njëri vit në tjetrin, por nuk disponojnë një manual/udhëzues për studentët.</p> <p>Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit akademik, të cilat publikohen në faqen zyrtare të UART.</p> <p><i>Evidenca I.I.1.3.9 Rregullore studimi piano.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Konstatohet se Njësia e Karrierës dhe Alumnit informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale të tregut të punës. Njësia e Karrierës dhe Alumnit orienton studentët për zgjedhjen e karrierës së tyre, rritjen e kontakteve, vetëpunësimin dhe mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme artistike që institucioni organizon.</p> <p><i>Evidenca Te Diplomuarit - Piano 2002-2021.</i></p> <p><i>Evidenca VSA Nr_21, dt_07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit te Studenteve, Keshillimit te Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i></p> <p><i>Evidenca I.I.2.5.2 foto nga koncerte, masterclasse, takime etj.pdf të pedagogëve të FM, studentë aktualë dhe ALUMNI FINAL</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Çdo fillim të vitit të parë të studimeve, DI, në bashkëpunim me Njësinë e Karrierës dhe Alumnit, organizojnë javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive; oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. Në faqen e internetit të UART, gjithashtu gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritë mësimore, bibliotekën, laboratorët etj.</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pgcfage&idc44&nivelic3</p>



<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Konstatohet se informimi i studentëve, realizohet nëpërmjet platformës Microsoft Teams dhe Pitagora, sikurse pohan edhe vetë studentët gjatë takimit fizik, arrijnë të ndërveprojnë gjatë realizimit të procesit mësimor, platforma të cilat kanë shërbyer për zhvillimin e procesit mësimor dhe artistik edhe gjatë periudhës së Pandemisë. Ndërsa informacioni mbi kurrikulat e studimit, aktivitetet dhe kalendarin mësimor publikohen online dhe janë lehtësisht të arritshëm nga studentët në distancë.</p> <p><i>Evidenca Manuali i përdorimit të sistemit Microsoft Teams</i> <i>Evidenca II.2.1.1 Manual - studenti në sistemin Pitagorë (2).</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që në faqen e internetit të UART gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, bibliotekën, laboratorët etj.</i> <i>Njëësia e Karrierës dhe Alumnit informon dhe orienton studentët mbi mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme artistike që institucioni organizon.</i> <i>Rezulton se në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale si Rregullorja e Programit të Studimit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe prapë prapë kalimit nga njëri vit në tjetrin.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Raportit të Vetëvlerësimit të Programit dhe Plani strategjik për zhvillimin e institucionit, konstatohet se institucioni paraqet raporte vjetore për veprimtarinë e kryer.</p> <p>Konstatohet, gjithashtu, që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve për secilin program studimi që UART ofron, specifiku për Master i Arteve Piano dhe Mësuesi, rezultojnë të regjistruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për vitin akademik 2019-2020 në total 7 studentë; • për vitin akademik 2020-2021 në total 5 studentë; • për vitin akademik 2021-2022 në total 5 studentë;

	<p><i>Evidenca Te dhenat e studenteve qe kane mbaruar per Piano.</i></p> <p><i>Evidenca I.I.1.3.3 VSA Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe Rregullorja e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës, rezulton se Sekretaria Mësimore është zyra e cila është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti apo transkripti lidhur me studentët.</p> <p>Nga vizita në institucion me sekretarinë mësimore konstatoam se ajo disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatre hyrëse dhe dalëse, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Nga vizita në institucion me përfaqësues të Njësisë së Karrierës dhe Alumnit (NjKA) konstatoam se ajo mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre. Rezultoi se NjKA në bashkëpunim me sektorin mësimor, bazuar edhe në Rregulloren e Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike, mobilitet studentor si dhe informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo/edhe aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca VSA Nr_21, dt_07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores të Funksionimit Sektorit Mësimor dhe Kurrikules, Informimit të Studenteve, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI në UART.</i></p> <p><i>Evidenca Rregullore e Funksionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART.</i></p> <p><i>Evidenca Te dhenat e studenteve qe kane mbaruar per Piano.</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se sekretaria mësimore e FM disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu, ajo ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit vit akademik, transferimet dhe çregjistrimet, ecurinë akademike të studentit, numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen. Sekretaria ruan dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në sistemin Pitagora dhe database-n Excel që disponon.</p>

	<p><i>Evidenca Rregullore e Funkcionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART.</i></p> <p><i>Evidenca Te dhenat e studenteve qe kane mbaruar per Piano.</i></p> <p><i>Evidenca III.2.1.1 Manual - studenti ne sistemin Pitagorë (2).</i></p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Bazur ne Rregulloren e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FM si dhe ne Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART rezulton se institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse si sekretaritë mësimore, sektoret e Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</p> <p><i>Evidenca Rregullore e Funkcionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART.</i></p> <p><i>Evidenca VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Konstatohet se institucioni harton në mënyrë periodike raporte vjetore në rang njësie bazë. Sekretaria Mësimore gjithashtu, disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalje.</p> <p><i>Evidenca I.I.3.1.15 - Analize vjetore DI.</i></p> <p><i>Evidenca Te dhenat e studenteve qe kane mbaruar per Piano.</i></p> <p><i>Evidenca Cilesia ne hyrje</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatare hyrëse dhe dalje, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi.</i></p> <p><i>Ky standard u përmbush plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

Standardi V.5
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Konstatohet që studentët e UART janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës si dhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm si dhe gjithashtu janë pjesë e komisionit të marrëdhënieve me studentët, ngritur në Tetor të vitit 2021 në rang institucional.</p> <p><i>Evidenca I.1.1.2.1 Statuti_uart_2021.</i> <i>Evidenca II.5.1.7 komunikim zyrtar shkresor per akreditimin., Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë master në FM.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Rezulton që institucioni është i angazhuar që të garantojë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet përfaqësuesve në Senatin Akademik, në grupin e ngritur nga NjZHKC për hartimin e GVB në kuadër të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Institucioni nuk ka paraqitur asnjë evidencë që të dëshmojë ngritjen dhe funksionimin e Këshillave Studentore.</p> <p><i>Evidenca I.1.1.2.1 Statuti_uart_2021.</i> <i>Evidenca II.5.1.7 komunikim zyrtar shkresor per akreditimin., Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë master në FM.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Konstatohet se studentët janë të përfshirë në takimet e organizuara nga Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, që kanë për detyrë të monitorojnë cilësinë e zbatimit të kurrikulës në cikle të ndryshme të studimit si dhe të mbështesin punën e njësisë bazë për akreditimin, hartimin e programeve të reja të studimit etj, si dhe janë pjesë e GVB, për hartimin e RVB për Programin e Studimit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi.</p> <p><i>Evidenca II.5.1.7 komunikim zyrtar shkresor per akreditimin., Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë master në FM.</i> <i>Evidenca Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe</p>	<p>Bazuar në të dhënat e pyetësorit të studentëve, studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës.</p> <p><i>Evidenca Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula.</i></p>

reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.									
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që studentët e UART janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatën Akademik, në Këshillin e Etikës si dhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm dhe u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës.</i> <i>Për sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimet të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Konstatohet se institucioni paraqet procedura të qarta për informimin e studentëve nëpërmjet Sektorit Mësimor & Kurrikulës. Zyra e Informimit të Studentëve si dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni angazhohen në mbështetje të studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve master. DI në bashkëpunim me zyrat e sipërcituara vëne në dispozicion të tyre, materiale dhe broshura informuese dhe orientuese si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për programin e studimit që do të ndjekin. <i>Evidenca VSA Nr_21, dt_07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores të Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit të Studenteve, Keshillimit të Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Konstatohet që nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të UART dhe Sekretarisë Mësimore, studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim etj. Gjithashtu, informacione më të detajuara për profilin e tyre personal, realizohet nëpërmjet aksesit në sistemin Pitagora. <i>https://uart.pitagora.rash.al/login</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës.	Konstatohet se nëpërmjet Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve si dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për


<p>Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, aktiviteve të ndryshme artistike që institucioni organizon. Gjithashtu ky sektor ofron informacion për bursa, informacion në lidhje me mobilitetet dhe programet e shkëmbimeve jashtë vendit si dhe në bashkërendim me DI orienton studentët për zhvillimin e praktikës profesionale.</p> <p><i>Evidenca I.I.3.2.1 Uart agder 2021 agreement. Evidenca I.I.3.2.1 Uart agder 2021 agreement, Evidenca I.I.3.4.1 Universiteti i Arteve - Statistikat ICM - shtator 2022.pdf Endra Të dhëna mbi mobilitetin e studentëve FM , Evidenca I.I.1.1.5 Urdher-Nr.100-dt.25.2.2022-RREGULLORJA-PER-ZHVILLIMIN-E-PRAKTIKAVE-PROFESIONAL-TE-MESUESIT.pdf</i></p>
---	--

<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Konstatohet që Këshillimit të Karrierës dhe Alumni ka nisur procesin e gjurmimit të studentëve pas diplomimit duke krijuar ura bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe studentëve aktual të institucionit.</p> <p><i>Evidenca Te Diplomuarit - Piano 2002-2021.</i></p> <p><i>Evidenca Aktivitetet e Stafit, Studenteve dhe Alumni te FM.</i></p>
---	---

<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim. Gjithashtu, konstatohet se nëpërmjet Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve si dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës së tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, aktiviteve të ndryshme artistike që institucioni organizon.</i></p> <p><i>Për sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>
---------------------------	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Universiteti i Arteve për vetë specifikën e programeve që ofron, ka hartuar Rregulloren e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës si Rregulloren e ciklit të II të studimit Master në UART ku jepen direktiva të qarta për zhvillimin e kurrikulës dhe përdorimin e metodave bashkëkohore që duhen përdorur në procesin mësimor. Ato orientojnë për punën që duhet bërë në lidhje me hartimin e sylabuseve lëndore, përzgjedhjen e literaturës, metodat bashkëkohore, sistemin e kontrollit dhe të vlerësimit të dijeve të studentëve, këshillimin akademik dhe tutoriatin, etj.</p> <p><i>Evidenca I.I.1.3.8 VSA 2 Rregullorja e studimeve cikli 2 Master - teksti integral rev EK.</i></p> <p><i>Evidenca I.I.3.1.12 VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i></p> <p><i>Evidenca I.I.1.3.7 Rregullore e Universitetit të Arteve VSA Nr.20 dt.07.10.2021.</i></p> <p><i>Evidenca VKM Nr. 145, datë 10.03.2021, "Për dhënien e Statusit të veçantë UART si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë".</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Nga vizita në institucion konstatuam se institucioni ka ngritur një komision ad-hoc për monitorimin dhe sigurim e cilësisë në UART. Në këtë rregullore përcaktohen rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe të programeve të studimit dhe të marrëdhënieve me strukturat e tjera brenda universitetit. Disa forma që institucioni përdor për vlerësimin e performancës së universitetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analiza vjetore e departamentit, - Analiza vjetore në rang institucional; - Vlerësimi i mësimdhënies nga studentet. <p>Rezulton se, institucioni nuk ka paraqitur evidencë që të dëshmojnë vlerësimin në mënyrë periodike të punës artistike-mësimore dhe shkencore të stafit akademik të FM.</p> <p><i>Evidenca I.I.3.1.14 -Urdher-Rektori ANALIZA VJETORE.</i></p>

	<p><i>Evidenca I.I.3.1.15 - Analize vjetore DI.</i></p> <p><i>Evidenca Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula.</i></p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Spektori Mësimor & Kurrikulës është përgjegjës për organizimin dhe përpunimin e të dhënave që dalin nga analiza e përgjigjeve të pyetësorëve që iu drejtohen studentëve në lidhje me vlerësimin e formave të mësimdhënies, vlerësimin e dijeve të tyre, duke iu dhënë mundësi për ankimime dhe trajtim të tyre.</p> <p>Spektori Mësimor & Kurrikulës organizon në mënyrë periodike pyetësorët me studentët dhe i bën të ditur për stafin akademik rezultatet që dalin pas përpunimit. Këto raportime më pas dërgohen edhe në strukturat drejtuese të UART. Çdo pedagog ka të drejtën të njihet me vlerësimin që iu bëhet nga studentët.</p> <p><i>Evidenca Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula.</i> <i>Evidenca VSA Nr_ 21, dt_ 07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit te Studenteve, Keshillimit te Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i></p>		
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Spektori Mësimor & Kurrikulës është përgjegjës për realizimin e pyetësorëve të studentëve, për përpunimin e tyre dhe për shpalljen e rezultateve, qoftë në rrugë konfidenciale, qoftë në rrugë publike.</p> <p><i>Evidenca VSA Nr_ 21, dt_ 07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit te Studenteve, Keshillimit te Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit, ndryshe nga praktikat e të kaluarës nuk shërbejnë si penalitete, por si modele që duhen përmirësuar dhe nxitur në mënyrë konstruktive. Ato i shërbejnë institucionit, departamenteve dhe vetë pedagogëve për të qenë më aktivë në planet e zhvillimit strategjik të institucionit, programit të studimit dhe lëndëve të veçanta.</p> <p><i>Evidenca I.I.1.3.3 VSA Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.</i> <i>Evidenca Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART.</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni ka ngritur një komision ad-hoc për monitorimin dhe sigurim e cilësisë në UART dhe se Spektori Mësimor & Kurrikulës organizon në mënyrë periodike pyetësorët me studentët duke përmbyshur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbyshet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbyshjes së</p>	<p>Përmbyshet</p>	<p>Përmbyshet</p>	<p>Përmbyshet</p>

standardit		pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënljgore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, rezulton se institucioni ka hartuar politika për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UART bazohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Standardet Shtetërore për Sigurimin e Cilësisë. Institucioni ka ngritur një Komision Ad-Hoc për Sigurimin e Brendshëm të Standardeve të Cilësisë dhe aktualisht, organizimi strukturor i brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë realizohet përmes Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe bazuar në organigramën e UART, rezulton se intitucioni ka në strukturë të saj njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, por është ende në proces realizimi.</p> <p>Rekomandohet ngritja e NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Bredshëm të Cilësisë referuar, Nenit 35 të Statutit UART.</p> <p><i>Evidenca I.I.2.1.4 Organigrama FM Organigrama FM (2).</i></p> <p><i>Evidenca I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.</i></p> <p><i>Evidenca VSA Nr_ 21, dt_ 07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funkionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit te Studenteve, Keshillimit te Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Konstatojmë që, institucioni ka ngritur një Komision Ad-Hoc për Sigurimit e Brendshëm të Standardeve të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku janë të përfshirë jo vetëm stafi akademik, por edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm.</p> <p><i>Evidenca 1.15.2 Urdhër të MASR Nr. 319 datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART”. Bashkëngjitur Statuti.</i></p>


	<p><i>Evidenca Urdhëri FM Nr. 01, dt. 10.03.2022, Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë master në FM.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet që institucioni përdor disa instrumente matës për sigurimin e cilësisë siç janë pyetësor për studentët për matjen e cilësisë së procesit mësimor. Gjithashtu, rezulton se institucioni realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional, raporteve analitike të vlerësimit të brendshëm që institucioni harton.</p> <p><i>Evidenca Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula..</i> <i>Evidenca I.I.3.1.14 -Urdher-Rektori ANALIZA VJETORE.</i> <i>Evidenca I.I.3.1.15 - Analize vjetore DI.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet që, institucioni kryen sondazhe me studentët për procesin e mësimdhënies si dhe raporteve vjetore që hartohen në rang institucional si dhe në nivel njësie bazë për punën artistike si dhe mësimore-shkencore të stafit akademik, por rezulton se, institucioni nuk ka paraqitur evidenca që të dëshmojnë vlerësimin në mënyrë periodike të punës artistike-mësimore dhe shkencore të stafit akademik të FM.</p> <p>Rekomandohet ngjitja e instrumenteve matës për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive të punës artistike-mësimore dhe shkencore të stafit akademik si dhe hartimi i raporteve periodike për ecurinë e tyre.</p> <p><i>Evidenca Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula..</i> <i>Evidenca I.I.3.1.14 -Urdher-Rektori ANALIZA VJETORE.</i> <i>Evidenca I.I.3.1.15 - Analize vjetore DI.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se aktualisht, organizimi strukturor i brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë realizohet përmes Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Institucioni ka në strukturë të saj njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, por është ende në proces realizimi. Ndaj, rekomandohet ngritja e NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë referuar Nenit 35 të Statutit UART.</i></p> <p><i>Gjithashtu konstatohet që, institucioni kryen sondazhe me studentët për procesin e mësimdhënies si dhe raporteve vjetore që hartohen në rang institucional si dhe në nivel njësie bazë për punën artistike si dhe mësimore-shkencore të stafit akademik, por rezulton se, institucioni nuk ka paraqitur evidenca që të dëshmojnë vlerësimin në mënyrë periodike të punës artistike-mësimore dhe shkencore të stafit akademik të FM.</i></p> <p><i>Për sa me sipër, rekomandohet ngjitja e instrumenteve matës për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive të punës artistike-mësimore</i></p>

	<i>dhe shkencore të stafit akademik si dhe hartimi i raporteve periodike për ecurinë e tyre.</i>		
	<i>Ky standard përmbushet kryesisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezulton se, institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve periodike të raportit të vlerësimit të brendshëm, i cili përfshin analizën e objektivave të programeve të studimit që FM ofron, metodat e mësimit, organizimin dhe administrimin e tyre si dhe format e vlerësimit, veprimtaritë artistike dhe kërkimore shkencore duke analizuar faktorët e riskut për çdo kategori.</p> <p><i>Evidenca I.I.3.1.14 -Urdher-Rektori ANALIZA VJETORE.</i> <i>Evidenca I.I.3.1.15 - Analize vjetore DI.</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Strategjik të UART dhe Analiza vjetore e UART dhe DI, rezulton se institucioni ka përfshirë analizën SËOT, gjatë së cilës trajtohen rezultatet e vlerësimit, rezultatet e pritshme, mangësive dhe pritshmëritë për përmirësimin në vijim të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca I.I.3.1.3 VSA Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.</i> <i>Evidenca I.I.3.1.14 -Urdher-Rektori ANALIZA VJETORE.</i> <i>Evidenca I.I.3.1.15 - Analize vjetore DI.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit</p>	<p>Rezulton se institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i cilësisë së mësimit nga studentët;

<p>të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Fokus grupet për vlerësimin e mësimdhënies; • Analizën vjetore të departamentit; <p><i>Evidenca Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula. Evidenca I.I.3.1.14 -Urdher-Rektori ANALIZA VJETORE. Evidenca I.I.3.1.15 - Analize vjetore DI.</i></p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Për vlerësimin stafit akademik nga studentët; 2) Për vlerësimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit nga studentët; 3) Analizën vjetore të Fakultetit; 4) Analizën e tregut të punës për programet e studimit të cilit të dytë të studimeve në FM <p><i>Evidenca Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula. Evidenca I.I.3.1- Analize vjetore FM. Evidenca Studimi i Tregut FM me vula.</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve periodike si dhe përdor metoda dhe instrumente të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Rezulton që, nëpërmjet analizës SWOT të Planit Strategjik të UART, Analizën vjetore të FM si dhe Analizës së tregut të punës për programet e studimit të cilit të dytë të studimeve në FM, institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca I.I.1.3.3 VSA Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.</i> <i>Evidenca I.I.3.1- Analize vjetore FM.</i> <i>Evidenca Studimi i Tregut FM me vula.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rezulton se institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar në GVB për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij program studimi, duke garantuar kështu ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p><i>Evidenca RVB Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve Piano dhe Mësuesi.</i> <i>Evidenca Urdhëri i Rektorit të UART Prof. Kastriot Çaushi, me Nr. 283, datë 28.02.2022, "Mbi ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër akreditimit të programeve cikli II.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Rezulton se anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit në rang departamenti dhe fakulteti, siç pasqyrohet edhe në Rregulloren e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</p> <p><i>Evidenca VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i> <i>Evidenca I.I.1.3.8 VSA 2 Rregullorja e studimeve cikli 2 Master - teksti integral rev EK.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UART, Rregulloren e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës si dhe Rregulloren e këtij program studimi, rezulton se institucioni rregullon integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve.</p> <p><i>Evidenca VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i> <i>Evidenca Rregullore e programit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi.</i></p>

	<i>Evidenca I.I.1.3.7 Rregullore e Universitetit te Arteve VSA Nr.20 dt.07.10.2021.</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Rezulton se, marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka me me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, me institucionet arsimore për realizimin e praktikave profesionale, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus + luajnë rol aktiv në sigurimin e brendshëm të cilësisë së këtij program studimi. <i>Evidenca I.I.3.3.1 Tabela 5 Marreveshjet.</i> <i>Evidenca I.I.3.3.2 Marreveshje FM me ZVA Vlore.</i> <i>Evidenca I.I.3.2.1- I.I.3.2.10. Uart agder 2021 agreement - Marrëveshjet e Bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus +.</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit duke përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i> <i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Rezulton se institucioni ka hartuar politika të qarta për publikimin e veprimtarive në kuadër të sistemit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë transparente dhe bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të UART. <i>http://www.uart.edu.al/index.php?pgcfaqe&idç549&niveliç124</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat	Konfirmojmë që, institucioni ka hartuar Planin Strategjik Institucional, Rregulloren në rang njësie baze, Rregullren për programin e studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.



personale.	<p><i>Evidenca I.I.I.3.3 VSA Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.</i></p> <p><i>Evidenca VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i></p> <p><i>Evidenca Rregullore e programit Master i Arteve Piano dhe Mësuesi.</i></p> <p><i>Evidenca I.I.I.3.7 Rregullore e Universitetit të Arteve VSA Nr.20 dt.07.10.2021.</i></p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>Konstatohet se në Planin Strategjik të UART është hartuar analiza për sigurimin e cilësisë e shoqëruar me një plan masash që synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p><i>Evidenca I.I.I.3.3 VSA Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.</i></p>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>Konstatohet se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, mbështetur në Rregulloren e e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni dhe Rregulloren e veprimtarisë së përgjithshme DI miratur nga Senati Akademik.</p> <p><i>Evidenca VSA Nr_ 21, dt_ 07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores të Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit të Studenteve, Keshillimit të Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i></p> <p><i>Evidenca VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i></p> <p><i>Evidenca VSA_45 Rregullore e Departamentit Interpretim FM.</i></p>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe diskutimet e realizuara nga takimi me Sektorin Mësimor & Kurrikulës, rezultoi se institucioni organizon takime periodike me stafin akademik, ndihmës dhe studentët për t'i informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotesojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti.</p> <p><i>Evidenca VSA Nr_ 21, dt_ 07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores të Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit të Studenteve, Keshillimit të Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i></p>
Konkluzione	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni ka hartuar Planin Strategjik Institucional, Rregulloren në rang njësie baze, Rregullren për programin e studimit, duke respektuar</i></p>

	<i>lirinë dhe etikën akademike duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i>			
	<i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve “Piano dhe Mësuesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Fakulteti i Muzikës është i angazhuar në projekte ndërkombëtare që ndihmojnë në shkëmbimin e përvojave, mobiliteteteve për personelin akademik dhe studentët.
2. Fakulteti i Muzikës ka hapësira të mjaftueshme dhe të pajisur me infrastrukturë digjitale, në funksion të programit të studimit.
3. Institucioni ka një bibliotekë të pasur dhe të pajisur me kompjutera, për dëgjimin e veprave muzikore.
4. FM aplikon programe studimore të ndërtuara mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, me ngjashmëri me programe studimi evropiane.
5. Studentët angazhohen në Orkestrën Evropiane e të Rinjve, referuar projektit CEMAN, si një formë e shkëlqyer prezantimit me tregun ndërkombëtar të punës.
6. Punësimi i studentëve është i lartë, i matur përmes projektit GRADUA.
7. Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja në projekte të përbashkëta artistike, mes stafit akademik, Alumni dhe studentëve është një element shumë i rëndësishëm institucional.
8. Institucioni aplikon Masterclasses, si një formë e rëndësishme për përmirësimin e mësimdhënies, përmes njohjes së modeleve më të sukseshme të artistëve evropianë.

Pika të dobta:

1. Rezulton se, institucioni respekton Rregulloren Mësimore të Ciklit të Dytë Master dhe Kodin e Etikës në të cilat sanksionohet mos-lejimi i plagjiaturës dhe kopjimit në provime, në lëndët teorike, por nuk disponon një sistem antiplagjiaturë. [Standardi III.3, Kriteri 5]
2. Rezulton se numri i teksteve fizike dhe elektronike në fushën e edukimit (literature bazë dhe e këshillueshme) është i vogël për plotësimin e nevojave të studenteve në realizimin e leksioneve, detyrave dhe projekteve të kurseve me karakter psiko-pedagogjik që ky program studimi ofron për formimin e mësuesve të ardhshëm. [Standardi IV.3, Kriteri 4]
3. Rezulton se, institucioni ka ngitur në strukturë të saj komisionin Ad-Hoc, Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, por Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është ende në proces realizimi. [Standardi VI.2, Kriteri 1]
4. Rezulton se institucioni nuk disponon instrumente matëse efikase për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive të punës artistike-mësimore dhe shkencore të stafit akademik. [Standardi VI.2, Kriteri 4]

Rekomandime:

1. Rekomandohet përdorimi i sistemit antiplagjiaturë.

2. Rekomandohet shtimi i fondit të teksteve fizike dhe elektronike në fushën e edukimit (literature bazë dhe e këshillueshme) për plotësimin e nevojave të studenteve në realizimin e leksioneve, detyrave dhe projekteve të kurseve me karakter psiko-pedagogjik që ky program studimi ofron për formimin e mësuesve të ardhshëm.
3. Rekomandohet ngritja e NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Bredshëm të Cilësisë referuar, Nenit 35 të Statutit UART.
4. Rekomandohet ngritja e instrumenteve matës për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive të punës artistike-mësimore dhe shkencore të stafit akademik si dhe hartimi i raporteve periodike për ecurinë e tyre.

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master of Arts
"Pinao & Teaching" provided by the Higher Education Institution "University of Arts"**

Strengths and affirmations:

1. Faculty of Music is engaged in international projects that help exchange experiences, mobility for academic staff and students.
2. Faculty of Music has sufficient spaces and is equipped with digital infrastructure, in accordance with the study program.
3. The institution has a rich library equipped with computers for listening to musical works.
4. FM applies study programs built on the European Qualifications Framework, as well as European study programs.
5. Students are involved in the European Youth Orchestra, according to the CEMAN project, as an excellent form of introduction to the international labor market.
6. Student employment is higher, measured through the GRADUA project.
7. Cooperation and participation in joint artistic projects between the academic staff, Alumni and students is a very important institutional element.
8. The institution applies Masterclasses, as an important form for the improvement of teaching, through the recognition of the most successful models of European artists.

Weaknesses:

1. The institution respects the Teaching Regulations of the Second Master's Cycle and the Code of Ethics, which sanction the non-allowance of plagiarism and copying in exams, in theoretical subjects, but does not have an anti-plagiarism system. *[Standard III.3, Chritereon 5]*
2. Results that the number of physical and electronic texts in the field of education (basic and recommended literature) is small to meet the needs of students in the realization of lectures, assignments and course projects with a psycho-pedagogical character that this study program offers for the training of future teachers. *[Standard IV.3, Chritereon 4]*
3. The institution has set up the Ad-Hoc committee, the Internal Quality Assurance Unit, but The Permanent Commission of Quality Assurance is still in the process of being implemented. *[Standard VI.2, Chritereon 1]*
4. The institution does not have efficient measuring instruments for reflecting the state, achievements and weaknesses of the artistic-teaching and scientific work of the academic staff. *[Standard VI.2, Chritereon 4]*

Recommendation:

1. It is recommended to use the anti-plagiarism system.
2. It is recommended to increase the fund of physical and electronic texts in the field of education (basic and recommended literature) to meet the needs of students in the realization of lectures, tasks and projects of courses with a psycho-pedagogical character that this study program offers for teacher training upcoming.

3. It is recommended to set up the NJSBC and The Permanent Commission of Quality Assurance, referred to Article 35 of the UART Statute.
4. It is recommended to mount measuring instruments for reflecting the state, achievements and weaknesses of the artistic-teaching and scientific work of the academic staff, as well as the drafting of periodic reports on their progress.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADIINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X